ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.02(380) SHKURT 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

100-VJETORI

Kongresi i Lushnjës ngjarje madhore në historinë tonë kombëtare

Muharrem GJOKA - Nënkryetar i OBVL FAQE 6-7

NDERIMI

LAMTUMIRË MIKU YNË, AKADEMIK GURI SHYTI

Kol.Ing.Myfit GUXHOLLI FAQE 4

PROFIL

GJENERAL PARLLAKU, LEGJENDARI I PAVDEKSHËM!

Nga Kadri MORINA FAQE 12

Edhe gjatë vitit 2020, OBVL do të kontribuojë për historigrafinë shqiptare, për pasqyrimin me vërtetësi dhe pa politizime të LANÇ

OBVL - Përvoja e 25 viteve, garanci për suksese të mëtejshme në 2020

REFORMA ZGJEDHORE NË START TË MBARË

Nga Halil RAMA

Ngjarja më e rëndësishme politike e ditëve të fundit është krijimi i Këshillit Politik për reformën zgjedhore, me përfaqësues të maxhorancës dhe opozitës jashtëparlametare. OBVL përshëndet këtë zhvillim të rëndësishëm që erdhi pas marrëveshjes së arritur mes maxhorancës dhe opozitës, të cilat u ulën në një tryezë për reformën zgjedhore, si një nga kushtet e Bundestagut për çeljen e negociatave. Afati i përfundimit të reformës zgjedhore parashikohet brenda dy muajve të ardhshme deri më 15 mars 2020. Shqipëria do të ketë një ligj të ri zgjedhor plotësisht konsensual dhe sipas standardeve më të mira ndërkombëtare.

Krijimi i Këshillit Politik, tregoi se periudha njëvjeçare e daljes së opozitës zyrtare nga Parlamenti, ka prodhuar tashmë një realitet të ri politik. Megjithëse jemi në qëndrimet paraprake të palëve, duket se nuk do të kemi një ndryshim të sistemit elektoral, ndonëse komisioni duket i preokupuar që çdo opsion ta diskutojë në tryezë.

Kjo momentalisht është një arritje e re politike drejt reformave që Shqipëria po ndërmerr për t'u anëtarësuar në BE. Kishte muaj që kërkohej një dialog i hapur dhe gjithëpërf-shirës i dakorduar mes të gjitha forcave politike.

Reforma zgjedhore duhet të jetë plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Këtë ka kërkuar dhe Bundestag-u gjerman në rezolutën e tij të 26 shtatorit 2019.

OBVL kërkon që palët të kenë vullnetin politik dhe të punojnë për një marrëveshje që t'i rezistojë kohës dhe situatës kaotike në kushtet e krizës së besimit që ekziston midis faktorëve politikë elektoralë. Gjithsesi, kryesia e OBVL konstaton me kënaqësi se arritja e kësaj marrëveshje i hap rrugën dialogut të munguar, edhe për shumë çështje dhe zgjidhje të tjera.

SHBA, BE, OSBE dhe Britania e Madhe e kanë duartrokitur këtë hap, duke inkurajuar palët për të shkuar drejt një reforme që do të sjellë më pas zgjedhje të lira në standarte demokratike.

- *Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ ka për qëllim ruajtjen, propogandimin dhe pasurimin e traditave patriotike dhe luftarake të popullit tonë ndër shekuj dhe veçanërisht ato të LANÇ të popullit shqiptar. Ajo do të punojë për të rritur dhe forcuar dashurinë për atdheun dhe për realizimin e aspiratës së madhe të bashkimit kombëtar*

Kol.Ing.Myfit GUXHOLLI – Kryetar i OBVL FAQE 3

REFLEKSIONE

REALITETI I RREMË PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË

15 vjet nga masakra serbe në Reçak

Nga Bashkim Hisari FAQE 5

STUDIMI

Për Fishtën dhe jehonën e "lahutës"

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 10

IN MEMORIAM

DAVID LUKA, studiuesi i përmasave akademike

XHEMAL MEÇI FAQE 9

LETRAT

Kanuni i Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës) në një botim të ri

IDRIZ AHMETI. FAQE 11

ESSE

PËRRALLA E TË GJITHËPUSHTETSHMIT

LILJANA MUÇA FAQE 12

HOMAZH

PARTIZANI TRIM HEKURAN DILKA

FAQE 4

PROFIL

MARK DEDA, PLAKU LEGJENDAR I BJESHKËVE TONA

FAQE 8

ANALIZA

Edhe gjatë vitit 2020, OBVL do të kontribuojë për historigrafinë

OBVL-Përvoja e 25 mëtejshme në 2020

Kol.Ing.Myfit GUXHOLLI
Kryetar i OBVL

• Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ ka për qëllim ruajtjen, propogandimin dhe pasurimin e traditave patriotike dhe luftarake të popullit tonë ndër shekuj dhe veçanërisht ato të LANÇ të popullit shqiptar. Ajo do të punojë për të rritur dhe forcuar dashurinë për atdheun dhe për realizimin e aspiratës së madhe të bashkimit kombëtar

Që me krijimin para 25 vitesh, OBVL përcaktoi në pltaformën e saj përpjekjet për bashkimin e veteranëve të LANÇ në një organizatë të vetme. Në themel të veprimtarisë së saj ka qenë vlerësimi realisht i historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit diktatorial të E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë e LANÇ. Pas viteve "90 dhe ndryshimeve demokratike që ndodhën në Shqipëri, një kontribut dha edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL). Është i njohur kontributi i saj gjatë procesit të ndryshimeve demokratike e deri më sot.

PAK HISTORI

Para tri dekadash, një grup intelektualësh - ish partizanë, udhëheqës të luftës NCÇl dhe luftëtarë, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist morën iniciativën për krijimin e një organizate që do të funksiononte e vepronte në të mirë të Shqipërisë dhe demokracisë.

Qysh më 1993 punohej për krijimin e kësaj organizate dhe më 1994 u shpall grupi nismëtar i krijimit të OBVL prej 39 vetash. Në përbërje të këtij grupi ishin: Dr.Ymer Dishnica, Andon Sheti, Alfred Moisiu, Deli Balili, Edip Ohri, Rrahman Parllaku, Sadik Bekteshi, Ernest Jakova, Hamit Keçi, Irakli Bozo, Kiço Ngjela, Muhamet Prodani, Nurie Bozo, Nexhip Vinçani, Nreçi Plasari, Myfit Guxholli, Skënder Malindi, Dashamir Ohri, Josif Zegali, Myftar Tare, Nexhmi Ballka, Xhavit Qesja, Zenepe Ashiku, Selfixhe Broja, Liri Belishova, Tanush Shyti, Zekie Prodani, Sami Vinçani, Taqo Adhami, Tahir Voshtina, Guri Shyti. Më vonë u shtua grupi nismëtar dhe me 30 anëtarë të tjerë si: Ali Butka, Bedri Shehu, Elami Hodo, Haki Jupasi, Hysni Daja, Islam Bushi, Janaq Budina, Koço Qafëzezi, Musa Shehu, Mentor Belegu, Manol Konomi, Neshat Iliazi, Petrit Malindi, Skënder Godo, Sami Haderi, Sotir Budina, Sitki Bushati, Koço Leshnja, Kol Jakova, Munir Kroi, Myzafer Mati, Shefqet Mëzini e Sheraf Gjebrea.

Siç shihet në këtë grup bënin pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e deri ministra.

Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnica. OBVL i bëri thirrje Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare për bashkim, por me kushtin e zgjedhjeve të reja në bazë dhe në qendër të veteranëve, të ndryshimit të statutit dhe programit, të rishikimit të historisë së LANÇ, të dënimit të krimeve të komunizmit. Këto kërkesa u refuzuan nga Komiteti Kombëtar i Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare. Menjëherë pas zgjedhjes, Kryesia e OBVL ju vu punës për përgatitjen e projektligjeve që do të vinin në vendin e merituar figurën e respektuar të veteranit të LANÇ dhe propozimin e miratimin e tyre në parlament, duke e vënë kështu veprimtarinë e saj mbi baza ligjore, në interës të veteranëve, invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Më këto ligje u ligjërua figura e respektuar e veteranit të LANÇ. Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrufeshëm në gjithë Shqipërinë: Në Tiranë me kryetar z.Muhamer Spahiu, Korçë, me kryetar Z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Muharrem Bushati, Lushnjë me kryetar.z.Iliaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Neziri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Jorgji Terca(Tiranë), Xhemal Meçi (Pukë), Agim Dylgjeri (Elbasan), Ali Demushi(Shkodër) etj.

Që nga krijimi i saj në korrik 1994, OBVL ka mbajtur shtatë kuvende kombëtare.

Organizata jonë e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, më 18 korrik të vitit të kaluar mbushi 25 vjet nga krijimi i saj. Para tre muajsh, më 1 Nëntor 2019, OBVL mbajti Kuvendin e saj të VII-të Kombëtar, që zhvilloi punimet tek Akademia e Shkencave në Tiranë, ku përveç delegatëve nga 12 degët e kësaj organizate në 12 qëraqet e vendit, morën pjesë dhe përshëndetën edhe zv/Ministri i Mbrojtjes Petro Koçi si dhe Gjeneral Brogade Manushaqe Shehu – zv/Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH-së. Ky Kuvend ishte i një rëndësie të veçantë, për vetë momentin historik në të cilin u mbajt, në kuadrin e 75-vjetorit të çlirimit të atdheut.

Organizata jonë, në këtë Kuvend, bëri një ndryshim cilësor në përbërjen dhe strukturën e saj organizuese e drejtuese. Megjithëse të vonuar, kurorëzuam përfshirjen në organizatë të pasardhësve, të parashikuar në Statutin tone, të miratuar që në mbledhjen themeluese dhe në Kuvendin tonë të parë.

Duke bërë këtë ndryshim në strukturë e përbërje, mendojmë se gjallërojmë Organizatën, për të përmbushur në vazhdim detyrat fisnike e historike të kujtimit të atyre që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë dhe të atyre që megjithëse bënë sakrifica sublime në luftë, për fat të keq e pësuan nga regjimi diktatorial. Në këtë Kuvend ne vendosëm që të vazhdojmë me brezat e ardhshëm, të mbrojmë lavdinë e asaj lufte heroike, ta ndihmojmë historinë të thotë të vërtetën. Ndërkohë, Gazeta "Veterani", organ i OBVL pasqyroi dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

VAZHDIMËSIA E OBVL NËPËRMJET PASARDHËSVE TË VETERANËVE

Që në themelimin e saj para 25 vitesh, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇl përcaktoi në dokumentat e saj themeluese, vazhdimësinë nëpërmjet pasardhësve të veteranëve. Në më shumë se dy dekada veprimtari intensive, krahas themeluesve, ish-veteranë

HISTORIA

shqiptare, për pasqyrimin me vërtetësi dhe pa politizime të LANÇ

viteve, garanci për suksese të

të LANÇl, drejtues të spikatur të formacioneve partizane dhe më vonë të ushtrisë shqiptare, si Dr.Ymer Dishnica, gjeneral Rrahman Parllaku, Skënder Malindi, Edip Ohri, Hamit Keçi, Tahir Voshtina, Shaban Reçi, Liri Belishova, Myfit Guxholli, Sotir Budina, Genci Ballanca, Fluturak Vinçani, Isuf Imeraj e dhjetra figura të tjera të shquara, pasardhësit e tyre kanë qenë të pranishëm. Dhe jo vetëm si figurantë, apo në sfond, por si pjesë vitale e kësaj organizate me një histori të lavdishme.

Jo vetëm përvoja shqiptare, por edhe ajo botërore evidenton domosdoshmërinë e vijueshmërisë së aktivitetit të organizatave të veteranëve të luftës. Është fakt që në veprimtaritë e ndryshme me karakter politik, patriotik e social, gjithmonë ka qenë i dukshëm kontributi i madh dhe i përhershëm i veteranëve. Por gjithsesi është e pamundur vijueshmëria e aktivitetit të OBVL, pa e trashëguar traditën tek më të rinjtë.

Në korrik 2016, në një Konferencë rajonale të organizatave të veteranëve të vendeve të rajonit të Ballkanit, që u mbajt në Zabljak të Malit të Zi, përveç, Prof. Dr.Ljubomir Sekuliq, si organizator, spikatën edhe dhjetra të rinj, si përfaqësues të organizatave të veteranëve të Kroacisë, Sllovenisë, Serbisë e Bosnje-Hercegovinës. Midis tyre edhe Presidenti i Federatës Botërore të Veteranëve, norvegjezi Dan Vigo Bergtun, i cili ishte rreth 40 vjeç.

Ajo që ra në sy në këtë event të rëndësishëm ishte prania e shumë pasardhësve të veteranëve. Nëse norvegjezi 40-vjeçar Dan Vigo Bergtun, vinte si President i Federatës Botërore të Veteranëve, kryetarja e Org.Veteranëve të Kroacisë ishte një e përafërt me të në moshë, si bija e një gjenerali kroat me emër. Të tillë ishin edhe përfaqësuesit e Serbisë e të Sllovenisë.

I solla këto shembuj për të evidentuar rolin që kanë pasardhësit edhe për vijueshmërinë e OBVL-së. Edhe në veprimtaritë e saj kanë qenë dhe janë prezentë në vijimësi zonjat e nderuara: Tatjana Parllaku, Arlinda Keçi, Mirjana Ohri, Marjana Zegali, Natasha Tahiri, Bujana Jakova, si dhe zotërinjtë: Sakip Cami, Maksim Vinçani, Muharrem Gjoka, Azis Keta, Kol Deda, Ilir Malindi, Natasha e Dashamir Tahiri, e disa të tjerë, vajza e djem të themeluesve e drejtuesve të OBVL-së. Por tashmë, që prindërit sa vijnë e largohen në moshë, është koha që ato të marrin përgjegjësi konkrete në organizimin dhe drejtimin e veprimtarive të kësaj organizate. Për më tepër, kur si pjesë vitale e saj janë bërë herë pas here edhe ikona të artit e kulturës sonë kombëtare, si artistet e popullit Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Rajmonda Bulku, apo edhe ish-ministrja e Arësimit Tefta Cami, nga pasadhësit e drejtpërdrejtë kërkohet një angazhim më i madh, që ata të trashëgojnë Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit

shqiptar (OBVL), historia e së cilës është me të vërtetë një hisori suksesi.

OBVL njihet tashmë si organizata që vlerëson lart kontributin e shquar të popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore, që dënon krimet e komunizmit, që mbështeti fort Luftën e drejtë të UÇK dhe në tërësi çështjen mbarëkombëtare shqiptare. Këto vlera janë përqafuar e propoganduar nga pasardhësit e denjë të veteranëve, si ish ushtaraku gazetari e shkrimtari i njohur Sakip Cami, nga historianët, studjuesit e publicistët e mirënjohur Xhemal Meçi e Nikolla Sudar, nga Ing.Kol Deda e Liljana Muça (Gegollari), por janë dhjetra të tjerë, ish ushtarakë të devotshëm, të mirëpritur në radhët e strukturat e OBVL.

Me prurjet e reja në organizatën tonë, si pasardhës, duke na u bashkuar edhe pasardhës të denjë veteranësh, si shkrimtari i mirënjohur Lutfi Hanku, ing.Maksim Vinçani, intelektuali Shuaip Methasani, veprimtari shembullor Muharrem Gjoka, kol.Azis Keta etj, shpreh bindjen për një të ardhme të sigurtë të OBVL.

Nëse organizata jonë nderohet e respektohet dhe i dëgjohet fjala kudo, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Prishtinë, Gjakovë e Prizren, apo edhe në veprimtari promovuese, siç ndodhi kohët e fundit në promovimet e librave të kryeredaktorit të gazetës "Veterani", Z.Halil Rama si dhe të ish ushtarakëve Sakip Cami, Kujtim Boriçi e Demir Rusi, është koha që ata pa asnjë mëdyshje të bëhen pjesë e kësaj organizate. Ish ushtarakë të shquar, të pranishëm në këto promovime, si gjeneral Dilaver Laçi, Ismail Shulku, Sokol Agolli e të tjerë do të ishin trashëgimia e vyer e kësaj organizate, anëtare e Federatës Botërore të Veteranëve. Ata kanë se ç'të mësojnë nga bilanci i pasur i veprimtarive, jo vetëm produktive, por edhe cilësore të OBVL, të fokusuara në konferenca shkencore e sesione jubilare, por dhe në botime produktive e cilësore.

TRADITA VAZHDON

Veteranët e LANÇ duan të ringjallin ato virtyte të shqiptarëve, të treguara gjatë shekujve, për t'i vënë përsëri në shërbim të Nënës Shqipëri, në udhën e re të vështirë të lirisë e të demokracisë, pajtimit dhe të bashkimit kombëtar, të vëllazërimit e të përparimit europian, të cilat u shprehën në idetë themelore të Konferencës së Pezës, bashkim pa dallim feje, krahine e ideje, me parrullën: bashkim, bashkim, bashkim në luftën kundër pushtuesit. Komunizmi si sistem dështoi dhe u shemb. Në Shqipëri diktatura komuniste i shërbeu Enver Hoxhës dhe klikës së tij, që e kthyen Shqipërinë në një burg të izoluar nga bota, e shkatërruan vendin ekonomikisht dhe nëpërmjet luftës së klasave i vranë njerëzit fizikisht dhe moralisht. Me këto veprime Enver Hoxha na zhgënjeu në rradhë të parë, ne veteranëve, ish luftëtarë të LANÇ dhe të gjithë popullin. OBVL ka dënuar diktaturën që u shëmb për të mos u kthyer më dhe veçanërisht krimet e saj.

Por në këtë qëndrim, me gjithë përpjekt tona për të patur mirëkuptim, Komiteti Kombëtar i Veteranëve të LANÇ ka vazhduar me po atë platformë të krijimit të tij që në vitin 1957, si një nga levat e PPSH dhe e diktaturës së Enver Hoxhës. Ky Komitet nuk shpreh dhe përfaqëson më interesat dhe ndryshimet reale demokratike të vendit tonë. Këto veprime dhe qëndrime krijuan pakënaqësi, mosbesim e përçarje. Kjo u vërtetua edhe në festimet me rastin e 75-vjetorin të çlirimit të Atdheut, kur u vendosën kurorat dhe u nderuan të rënët tek Varrezat e Dëshmorëve të Kombit. OBVL nuk u ftua të ishte pjesë e festimeve të këtij jubileu të lavdishëm.

Gjithsesi në veprimtarinë e saj 25 vjeçare ajo ka një bilanc dhe përvojë shumë të pasur dhe një histori suksesi.

E themeluar dhe e njohur zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë (para tre vitesh edhe me Vendim të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë", OBVL është bashkim vullnetar i ish - luftëtarëve të LANÇ, pasardhësve të tyre, ish-ushtarakëve si dhe i gjithë qytetarëve shqiptarë që mbrojnë dhe propogandojnë vlerat e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ është një organizatë patriotike pluraliste dhe e pavarur nga asnjë parti politike.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ ka për qëllim ruajtjen, propogandimin dhe pasurimin e traditave patriotike dhe luftarake të popullit tonë ndër shekuj dhe veçanërisht ato të LANÇ të popullit shqiptar. Ajo do të punojë për të rritur dhe forcuar dashurinë për atdheun dhe për realizimin e aspiratës së madhe të bashkimit kombëtar.

Si edhe gjatë 25 viteve të shkuara, OBVL edhe gjatë vitit 2020 do të kontribuojë për historigrafinë shqiptare, për pasqyrimin me vërtetësi dhe pa politizime të LANÇ.

Kjo organizatë do të ndihmojë për ruajtjen e pastër të idealeve të luftës NÇl. Ajo do të vazhdojë të dënojë veprimtarinë e kolaboracionistëve që bashkëpunuan me armikun.

OBVL në veprimtarinë e saj do të bashkëpunojë me të gjitha shoqatat dhe organizatat patriotike, sidomos në veprimtaritë përkujtimore për të nderuar të rënët dëshmorë të kombit në luftërat për liri, pavarësi dhe demokraci të popullit shqiptar, për përjetësimin e veprës së tyre.

Ajo do të kujdeset dhe ndërhyjë pranë organeve përkatëse, për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e varrezave, lapidarëve dhe objekteve historike të luftës.

Edhe gjatë vitit 2020, OBVL do të bashkëpunojë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe me organet e pushtetit vendor për përkujtimin e ngjarjeve historike të LANÇ, jubileve dhe figurave të saj.

NDERIMI

Homazh për akademikun që përtheu në shqip klasikë si Tolstoi, Turgenievi, Hygoi, Cvajku, Abati Prevo etj

Lamtumirë miku ynë, akademik Guri Shyti

• Guri Shyti ishte njeri i pajisur me intelekt e talent dhe si i tillë krijoi vepra të bazuara në talentin dhe arsimimin e tij. Ai ishte dhe mbetet simbol i intelektualit të mençur, të urtë, krijues i talentuar në fushën e veprimtarisë së tij. Krijimtarinë e vet intelektuale e drejtoj në të mirën e njerëzve

Kol.Ing.Myfit GUXHOLLI

Është ndarë nga jeta në ditën e parë të këtij viti, z. Guri Shyti.

Ai ka lindur në vitin 1930, në fshatin Tragjas të Vlorës.

Pesë klasat e shkollës fillore i kreu në fshatin e lindjes, pastaj bëri një klasë të shkollës tregtare të Vlorës në vitin shkollor 1941-1942.

Pas luftës hyri në Shkollën Ushtarake "Skënderbej". Që në bankat e shkollës së mesme provoi të shkruante ndonjë tregim, apo të përkthente ndonjë gjë nga gjuha ruse.

Pas saj u dërgua në ish-Bashkimi Sovjetik për studime ushtarake.

Pas kthimit, mbaroi studimet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës për Kimi Industriale.

Punoi në Ministrinë e Mbrojtjes, pastaj pedagog i kimisë ushtarake në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, e më vonë pedagog i Armëve të Dëmtimit në Masë në Akademinë Ushtarake, në Tiranë.

Guriu ishte, pedagog në Akademinë Ushtarake, në Universitetin e Tiranës dhe në shkolla të tjera të larta, përkthyes i letërsisë artistike dhe autor i disa librave.

Megjithëse prej shumë vitesh në pension, Guriu nuk e ndërpreu punën intelektuale deri në ditët e fundit të jetës.

Gjatë kohës ka shkruar në organe të ndryshme të shtypit, ka botuar libra për specialitetin e tij ushtarak.

Pas daljes në pension ka shkruar librin autobiografik me përjetime "Sikur të isha vetëm...". Ndërkohë, krijimtarinë e tij më të spikatur e gjejmë në librin "Një martesë e pazakontë", botur në vitin 2007 (Tregime, esse, vjersha.). Gjejmë këtu krijimtari sa produktive edhe cilësore të një prozatori, poeti e publicisti të mirëfilltë, ku reflektohet bota e tij shpirtërore si dhe përgatitja profesionale e akademike. Nëse tek proza e tij e shkurtër do të veçonim "Tregimet e Çimit" (mikut të rinisë me të cilin u ritakuan pas 50 vjetësh në një dasëm), apo "Lulet e pranverës", mendimin e tij filozofik Guri Shyti e evidenton më së miri në esenë me titull "Intelektuali i mirëfilltë", ku që në krye të herës, referuar fjalorëve encikolopedikë, shprehet se: "intelektuali është njeri i pajisur me intelekt, që ka talent dhe krijon vepra të bazuara në talentin dhe arsimimin e tij. E thënë më shkoqur, intelektuali është një njeri i mençur, i urtë dhe krijues i talentuar në fushën e veprimtarisë së tij. Nga pikëpamja njerëzore, intelektuali i mirëfilltë është human, zemërgjerë, që di t'u bëjë lëshime atyre që mendojnë ndryshe nga ai, është njeriu që dialogun me kundërshtarët e tij në mendime e ka në bazën e veprimtarisë së tij, njeri që krijimtarinë e vet intelektuale e drejton në të mirën e njerëzve, pavarësisht nga përkatësia politike, kombi apo raca....".

Pavarësisht këtyre referencave nga fjalori enciklopedik, në të vërtetë këto virtyre mishëronte në karakterin dhe intelektin e tij, intelektuali i mirëfilltë Guri Shyti. Po në këtë këndvështrim është edhe apeli i tij qytetar për gjuhën tonë.

Por Guri Shyti të mahnit me bukurinë e fjalës edhe ne krijimtarinë e tij poetike, veçanërisht në vjershtat me titull: "Atdheut", "Mos më lëndo", "Gruas në 50-vjetorin e martesës, Rrëfenjë për nipin", "Pavdekësia" etj.

Guri Shyti është marrë gjerësisht me përkthime. Ka përkthyer në shqip nga letërsia botërore, si nga gjuha ruse, edhe nga ajo italiane.

Ndër rreth tridhjet librat e përkthyer e të botuar, ka klasikë si Tolstoi, Turgenievi, Hygoi, Cvajku, Abati Prevo, Luiza Mei, Elkot, Kiplingu, Norvudi, Zveva, Kazati Modinjani, etj.

Ka përkthyer mjaftë vepra që kanë mbetur në dorëshkrim, për mungesë botuesi.

Me dinjitet i përballoi vështirësitë e jetës dhe burrërisht u përball me sëmundjen e kancerit në mushkëri deri në çastin që u shua.

Kryesia e OBVL i shpreh ngushëllime familjes dhe të gjithë shokëve dhe miqve të tij të shumtë.

PARTIZANI TRIM HEKURAN DILKA

Para disa ditësh ndërroi jetë pionirei i Brigadës së IV-të Sulmuese, Hekuran Dilka.

Ai ka lindur në fshatin Voskop të Korçës.

Hekurani rridhte nga një familje patriotike, që ishte një bazë e luftës. Duke mishëruar këto vlera të familjes u hodh që në fillim në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në fillim u aktivizua me Njësitin Gruerril dhe rininë e Rëzës, të cilat kryen aksione luftarake në depo e magazina të pushtuesit, nga ku rrëmbyen ushqime për t'ua shpërndarë familjeve në nevojë dhe partizanëve.

Më pas ai do të ishte pjesëmarrës në Brigadën e IV-të Sulmuese që në ditën e parë të krijimti të saj në Voskopjë atë fund dhjetori 1943. Si partizan aktiv i kësaj brigade luftoi me trimëri deri në ditën e fundit të çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist.

Për meritat në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Hekurani ka marrë disa Medalje Mirënjohje, të Çlirimit, Trimërisë, Kujtimit, etj, në vitet jubilarë të 50 e 60-vjetorit të çlirimit të atdheut.

Gjatë regjimit komunist, Hekurani u përndoq, por kurrë nuk rreshti së luftuari komunizmin.

Ai ishte i respektuar në zonën e tij sepse karektirizohej nga shpirti human dhe thjeshtësia. Si i tillë ishte shembull frymëzimi.

Me ardhjen e demokracisë Hekurani mbështeti zhvillimet demokratike. Ai ishte një demokrat i vërtetë, ndërkohë dha ndihmesë të shquar edhe në ngritjen e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ-it dhe gjatë gjithë kohës ishte kryetar i grupit të Voskopit.

Shembullin e tij e trashëgoi edhe i biri, Agim Dilka i cili është një nga aktivistët më të mirë të organizatës sonë. Si pasardhës i denjë e ka mbështetur shumë Degën e OBVL Korçë.

Jetëgjatësi e tij ishte një shpërblim për vepart e mira që ka bërë Hekuran Dilka. Ai iku për në botën e përtejme duke lënë gjurmë për të shërbyer si model frymëzimi për brezin e ri.

Ne si bashkëluftëtarë e bashkëpunëtorë të tij, do të na mungojë shumë, por edhe familjes që humbi njeriun më të shtrenjtë.

Gjithnjë do ta kujtojmë e nderojmë me respekt të veçantë siç Ai e meritonte.

Fluturak VINÇANI
Kryetar i Degës së OBVL Korçë

REFLEKSIONE

REALITETI I RREMË PËR KRIMET SERBE NË KOSOVË

15 vjet nga masakra serbe në Reçak

• *Duke mohuar krimet e kryera në Kosovë, regjim aktual serb, në krye me Aleksandar Vuçiqin, po krijon një klimë të skajshme të polarizimit me Republikën e Kosovës*

Nga Bashkim Hisari

Në fund të vitit që lamë pas, kancelarja gjermane Angela Merkel, bëri vizitën e saj të parë zyrtare në Aushvic- Birkenau, ku ushtarët SS pushkatuan mijëra vetë, shumica të burgosur politikë polak.

Në Aushvic, politkanja më e fuqishme në botë, Merkel, mbajti një nga fjalimet më të guximshme dhe më të rëndësishme në historinë evropiane. Në territorin e shtetit ndaj popullsisë së të cilit u krye gjenocidi, ajo, pa asnjë hezitim tha se kriminelët në Aushvic, duhet të thirren me emrin e tyre të vërtetë dhe se ata janë bashkëkombasit e saj gjermanë.

Në titujt e të gjitha mediave botërore dominoi deklerata e shefit të qeverisë gjermane Merkel se tmerri i Holokaustit ishte "i pakonceptueshëm" dhe se: "kujtimi mbi krimet naziste dhe pranimi i tyre është një pjesë e pandashme e identitetit kombëtar të gjermanëve". Ajo tha se është me rëndësi që kriminelët të quhen me emër të vërtet, theksoi faktin se autorët e krimit ishin gjermanë dhe se Gjermania ka një detyrim ndaj viktimave, që t'i përgjigjet përgjegjësisë."Unë ndjej turp të thellë përballë krimeve që u kryen këtu nga Gjermania" vuri në dukje Merkel.

Komiteti Ndërkombëtar i Aushvicit e quajti vizitën e Merkelit një "shenjë veçanërisht të rëndësishme të solidaritetit me ata që u mbijetuan tmerreve të Holokaustit".

Në këtë kontekst nuk mund të anashkalohen raportet e Serbisë me Kosovën. Në Serbi ku aktualisht e vërteta është fluide kurse urretja dhe propaganda luftënxitëse dukuri e shprehur, askush nuk mund të çelë gojën dhe të përmendi publikisht krimet gjenocidiale të forcave policore ushtarake dhe paraustaraka serbe ndaj shqiptarëve të pafajshëm, e mos të ketë pasoja negative dhe provokime. Në këtë shtet ku kriminelët bëhen heronjë, kurse krimet dhe viktimat janë thjesht vetëm numra memecë, mohimi i krimeve është rasti mirë për mashtrime dhe manipulime me popullin sidomos me mbeturinat e politikës Serbe Madhe.

Serbët në Kosovë kryen masakra kundër shqiptarëve duke qëlluar qytetarët të pafajshëm prej të cilëve nuk kursehej askush. Vranë dhe masakruan më shumë se 13.500 shqiptarë të cilët nuk kanë marrë pjesë në luftime, prej tyre 1.393 fëmijë, 1.379 gra. Rreth 1.600 persona ende janë të pagjetur Në Serbi janë zbuluar varrezat masivi me 941 kufoma të shqiptarëve të vrarë në Kosovë. Rreth 20.000 gra e burra vlersohet se ishin viktima të dhunës seksuale. Me forcë u dëbuan afro një milionë kosovarë dhe plaçkitën pronat e tyre dhe prona publike. U shkatërruan dhe u dëmtuan objektet civile, monumentet historike, arsimore dhe fetare. Hulumtimet treguan se nga 20 mijë puse të Kosovës, më shumë se gjysma u ndotën me kufoma kafshësh apo njerëzish, me plehra, ose thjesht u shndërruan në ujë i ndenjur prej mospërdorimit…Shumë segmente të këtyre krimeve ende nuk janë zbuluar. Autorët e krimeve kanë emër e mbiemër, disa janë dënuar nga Tribunali penal ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për krime, por një pjesë e madhe jo. Ekzistojnë dokumente dhe dëshimtarë që dëshmojnë për këto krime. Por, deri më tash asnjë politikanë, nacionalistë, qytetarë serb nuk tha se krimet në Kosovë i kanë organizuar dhe i kanë bërë serbët. Askush prej serbëve nuk tha kurrë, se këto krime kanë qenë të planifiukuara, organizuara dhe të zbatuara nga kriminelët serbë!

Përkundërazi, ata po mohojnë se në Kosovë kanë kryer krime dhe vepra penale. Me qëllim përhapin publikisht urrejtje, nxisin përçarje dhe mos durim mes serbëve dhe shqiptarëve që jetojnë në Kosovë vetëm për të ruajtur dhe shumëzuar përfitimet nga lufta.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mohon masakrën e Reçakut duke thënë se "masakra e Reçakut është një trillim i sajuar nga ish shefi i Misionit vëzhgues tëOSBE-s në Kosovë, Ambasadori ëilliam ëalker. Me këtë rast dëshmoi edhe njëherë se Srbia, në mënyrë institucionale ruan mendësinë e trashiguar nga koha e Millosheviçit.

Por çfar ndodhi në Reçak më 15 janar të vitit 1999?

Duke punuar si hulumtues për të dokumentuar abuzimet me të drejtat e njeriut përgjatë konfliktit të armatosur në Kosovë, intervistova disa dëshmitarë okular për masakrën e Reçakut të cilët dëshmuanë se më 15 janar 1999, forcat policore dhe ushtarake serbe, atje kishin kryer njërën ndër masakrat më të tmerrshme. Kishin vrarë dhe masakruar barbarisht 45 shqiptarë të paarmatosur. Ata treguan se atë ditë, në mëngjes herët, rrethë orë 6:00, forcat usthtarake policore serbe kishin rrethuar fshatin dhe janë pozicinuar në vendet e quajtura "Te pishat", "Gështenjat e Shtimes","Rrasat e Kollakut" dhe te "Kodra e Reçakut". Pastaj, është zhvilluar luftë në mes të ushtarëve të togut të Reçakut dhe mbi 400 forcave të përziera serbe. Fshati është bombarduar nga të gjitha anët. Kah mesdita, forcat serbe kanë hyr në fshat dhe kanë vrarë e masakruar në një vendë, 25 civilë shqiptarë të paarmatosur, të tjerët janë vra aty afër. Shumica kanë qenë pleq e fëmijë, në mesin e tyre një djalosh 17 vjeçar dhe një vajzë rreth 20 vjeçe. Në mbrojtje të civilëve janë vrarë edhe 16 ushtarë të UÇK-së. Banorët treguan se operacionin në Reçak e ka komaduar Goran Radosavljeviç-Guri, ndihmuar edhe nga shefi i policisë lokale Bogoljub Janiçijeviq.

Ambasadori amerikan ëilliam ëalker, i cili kishte shkuar për të parë nga afër këtë ngjarje, ishte tmerruar kur kishte parë kufomat. Sipas tij, këtu bëhej fjalë për një masakër, për një ekzekutim masiv të civilëve, që ishte kryer nga njësitet ushtarako-policore serbe. Të nesërmen, ai, deklaroi: "Nga ajo që pashë nuk ngurroj të përshkruaj ndodhinë si masakër dhe krim kundër njerëzimit…kjo është ngjarja më trishtuese në jetën time".

Trupat e civilëve të vrarë shqiptarë në Reçak janë dërguar në Prishtinë. Siç tha Shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, ëilliam ëalker, u numëruan 45 kufoma, ndërsa në raportet e Qendrës Informative të Kosovës figuronin se ishin më shumë se 50 trupa.

Qeveria Federale e Jugosllavisë e shpalli Ambasadorin ëalker person "nongrata" dhe urdhëroi të largohet nga Kosova. Njëherit akuzuan Bashkësinë ndërkombëtare se po shfrytëzon ngjarjet në Reçak si një fushatë e re kundër ish Jugosllavisë" dhe kundërshtuan vlersimet për këtë krim si të pabazuara e të pavërteta që sipas tyre kanë për qëllim të fajsojnë autoritetet e ish Jugosllavisë.

Ministri i Punëve të Jashtme gjerman Joshka Fisher dhe ai britanik Robin Kuk, kërkuan hetime të menjëhershme. Ata thanë se autorët e masakrës në Reçak duhet të përgjegjen para Tiribunalit të Hagës.

Kryeprokurorja e Tibunalit në Hagës Luis Harbur me një grup të hetuesëve erdhi në Kosovë për të shqaruar masakrën në Reçak, kurse sekretari Gjeneral i NATO-së Javier Solana, tërhoqi vërretjen se Aleanca nuk do të toleroj këthimin e një lufte të përgjakshëme dhe politikën represive në Kosovë.

Korespodenti i gazetës prestigjioze amerikane "The ëashington Post", Jeffrey Smith, duke cituar qarqet e intelegjencës më 28 janar, 13 ditë pas masakrës kishte raportuar se përgjimet telefonike kishin zbuluar se regjimi serb ka fshehur masakrën në Reçak. Ai kishte shkruar se sulmet e forcave serbe në Reçak kanë rezultuar me vrasjen e 45 shqiptarëve dhe se vrasjet ishin kryer me urdhër të zyrtarëve më të lartë komandues të qeverisë në Beograd të udhëhequr nga serbët të cilët pastaj me kujdes kanë rregulluar fshehjen e masakrës.

Masakra e Reçakut ishte një ndër ngjarjet më të dhimbëshme me pasoja më të rënda, por edhe ngjarje që ndikoi të bëhet një këthesë në politikën ndërkombëtare ndaj Kosovës dhe ringjalli përpjekjet e diplomacisë ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Reçaku solli Rambujen dhe intervenimin e NATO-së.

Është e qartë se nuk ka vend për mohimin ose relativizimin e masakrës që ndodhi në Reçak dhe që trondit opinionin ndërkombëtar. Megjithëatë, udhëheqësia serbe, në mënyrë të përsëritur është përpjekur të mohoj dhe të minimizoj masakrën e Reçakut të cilën e cilësojnë edhe si një aksion kundër "grupeve teroriste të UÇK-së të cilët u vranë nga policia në një operacion luftarak që ishte kundërpërgjegje për vrasjen e një oficeri policie nga pjestarët e UÇK-së ".

Mirëpo, nga raportet e OSBE-së, organizatave për të drejtat e njeriut, ekipet e ekspertëve mjekoligjorë, gjykimet para Tribunalit të Hagës, dokumentet të rëndësishme dhe deklaratave të dëshmitarëve, është e qartë se masakrën e kryen forcat serbe dhe fajtorët nuk janë ndëshkuar para drejtësisë. Poashtu është e qartë se pikëpamjet e shteti të kulturuar dhe civilizues gjerman, janë shumë large nga shteti serb dhe liderët politik të tyre që mohojnë dhe relativizojnë krimet e bëra duke mbrojtur vetëm vetëvehtën. Serbët, nuk janë liruar nga mitomanija, urretja dhe shofinizmi. Në shtetin e Serbisë me karakter autoritar, ende po dominojnë politikanët e korruptuar, kriminelët, mafiozët që bashkëpunojnë me politikanët, ku legjimitohet klijentelizmi, nepotizmi dhe resurset publike shfrytëzohen për qëllimet politke dhe keqëpërdoren ndenjat kombëtare duke trumpetuar me vite se „Kosova është Serbi"dhe se shqipraët janë terrorist. Prandaj, nuk mund të ndodhë që dikush prej tyre, të shpreh të vërtetën ashtu si bëri Angela Merkel. Pohimi edhe më i butë për të vërtetën për krimet e tyre nga ndonjë individ, do të ishte jo vetëm vetëvrasje politike por edhe shoqërore. Secili zyrtar, me pohime të tilla, do të largohej përgjithmonë nga jeta politike, madje jo vetëm politike. Të tillët do të dilnin para xhelatëve të maskuar me të zeza të errëta, të padukshëm, por të paharruar dhe mizorë, që për të tillët do të shqiptonin „dënimin e merituar" ngjashëm si kriminelët e viteve të 90- ta.

HISTORIA

Kongresi doli kundër Paktit të fshehtë të Londrës, të 26 prillit 1915-të, i cili sanksiononte copëtimin e Shqipërisë

100-vjetori – Kongresi i Lushnjës ngjarje madhore në historinë tonë kombëtare

• Kongresi i Lushnjes i zhvilloi punimet nga 21-31 janar të vitit 1920, në të cilin u miratua një akt kushtetues për pavarësinë e plotë të Shqipërisë, si dhe zgjodhi Këshillin e Lartë prej 4 vetash, që do të kryente funksionet e kryetarit të shtetit dhe një Këshill Kombëtar me 37 veta.



Nga Muharrem GJOKA
Nënkryetar i OBVL

KRYEMINISTËR U ZGJODH SULEJMAN DELVINA.

Kongresi i Lushnjes kreu punimet në shtëpinë e patriotit lushnjar, Kasëm Fuga, nga 21 deri më 31 janar te vitit 1920. Në Kongres morën pjesë delegatë të zgjedhur nga e gjithë Shqipëria. Qëllimi i Kongresit ishte studimi i situatës së brendshme dhe të jashtme të vendit dhe masat që duhet të merreshin për shpëtimin nga reziku i coptimit të Shqipërisë. Delegatëve i uroi mirëseardhjen në Kongres Ferit Vokopola që ishte delegati i Prefekturës së Beratit, Lushnjes dhe Skraparit. Pas Vokopolës, fjalën e mori patrioti i famshem i asaj kohe Aqif Pashë Elbasani. Aqif Pasha ju përgjigj shkurt të gjitha pyetjeve të bëra nga delegatët duke mbyllur keshtu ceremonin e hapjes së Kongresit. Mbas ceremonisë së hapjes, u bë ndarja e deputetëve nëpër grupe (komisione) të ndryshme, të cilat filluan nga puna menjëherë. Në mbledhjen e dytë të kongresit, e cila u mbajt më datën 24 janar, u zgjodh si Kryetar i Kongresit Aqif Pashë Elbasani. Po atë ditë nga ana e delegatëve u mbajtën fjalime të ndryshme mbi vrasjen e patriotit Abdyl Ypi, i cili kishte qenë një nga iniciatorët e mbajtjes së atij kongresi. Abdyl Ypin e kishin vrarë njerëzit e qeverisë së Durrësit, pak ditë përpara mbajtjes së asaj mbledhje, me qëllim që të frikësonin delegatët për të mos marrë pjesë në Kongresin e Lushnjes.

Mbas këtyre fjalimeve, me vendim unanim nga të gjithë delegatët u vendos që t'i dërgohej një telegram ngushëllimi familjes së Abdyl Ypit dhe pas formulimit të atij telegrami, u mbyllën punimet e asaj dite për të filluar të nesërmen më 30 janar. Mbledhja e tretë që u mbajt atë ditë, vendosi mbas shumë diskutimesh që të bëheshin protestat më të ashpra, kundër vendimit të Fuqive të Aleatëve, për zbatimin e Paktit të fshehtë të Londrës, i cili ishte mbajtur më 26 prill të vitit 1915-të, pakt i cili sanksiononte copëtimin e Shqipërisë. Pas këtij vendimi, mbledhja analizoi qëndrimin e qeverisë së Durrësit, si në situatën e brendshme, ashtu dhe në atë të jashtme. Nga kjo analizë u nxuarr si konkluzion se ajo qeveri kishte dalë dhe kishte vepruar jashtë programit të dhënë prej Kongresit të Durrësit, që ishte mbajtur në 25 dhjetor të vitit 1918-të. Po ashtu ajo qeveri kishte penguar mbledhjen e Senatit që ishte vendosur në Durrës dhe me administrimin e saj të keq, e kishte futur vendin në një anarki të madhe e kishte çuar në krijimin e një situate të acaruar politike. Nisur nga këto, ajo qeveri ishte përpjekur me çdo kusht për ta penguar mbajtjen e Kongresit të Lushnjes.

ZGJIDHET SENATI DHE QEVERIA

Për këtë arsye, kongresi vendosi unanimisht rrëzimin e qeverisë së Durrësit, e njëkohësisht zgjodhi imzot Luigj Bumçin, Mehmet Konicën dhe Dr. Turtullin, si përfaqësues legjitimë të popullit shqiptar, në delegacionin e Konferencës së Paqes në Paris. Në mbledhjen e katërt që u mbajt më 30 janar, kongresi zgjodhi si anëtarë të Këshillit të Lartë, imzot Bumçin, Aqif Pashë Elbasanin, Abdi Toptanin dhe Dr. Turtullin. Pas kësaj u zgjodh dhe përbërja e qeverisë së re, e dalë nga ai kongres e cila kryesohej nga kryeministri Sulejman Delvina. Pas Delvinës, në atë qevri u zgjodhën dhe Ahmet Zogu, Ministër i Brendshëm, Mehmet Konica, Ministër i Punëve të Jashtme, Hoxhë Kadria, Ministër i Drejtësisë, Ndoc Çoba, Ministër i Financave, Sotir Peci, Ministër i Arsimit, Ali Riza Kolonja, Ministër i Luftës, Eshref Frashëri, Drejtor i Përgjithshëm i

Punëve Botore dhe Idhomene Kosturi, Drejtor i Përgjithshëm i Postë-telegrafëve. Në mbledhjen e pestë që u mbajt më 31 janar pasdite, kongresi zgjodhi anëtarët e Senatit dhe u vendos që delegatët të mos shpërndaheshin derisa qeveria të merrte në dorë frenat e shtetit. Pas kësaj mbledhje, atë pasdreke të 31 janarit të vitit 1920-të, kongresi u dha fund punimeve të tija, duke vendosur Tiranën, për kryeqytet të Shqipërisë.

QEVERIA E DURRËSIT, KUNDËR KONGRESIT

Menjëherë pas përfundimit të kongresit në Lushnjë, po atë pasdreke të 31 janarit, Ahmet Zogu që u zgjodh Ministër i Punëve të Brendshme, u dërgoi të gjitha prefekturave një qarkore nga qyteti i Lushnjes, me anë të së cilës i bënte të ditur popullit shqiptar arsyet për mbajtjen e Kongresit Kombëtar të Lushnjes dhe u shpjegonte atyre vendimet që mori ajo mbledhje historike, për shpëtimin e Shqipërisë nga rreziqet që e kërcënonin. Gjatë gjithë punimeve të kongresit, ra në sy temperamenti i ndezur i Ahmet Zogut, që i bëri të gjithë delegatët të fitonin një admirim ndaj tij dhe ta zgjidhnin me votim unanim në postin delikat të Ministrit të Brendshëm, ndonëse ai nuk i kishte mbushur akoma 25 vjeç. Gjatë kohës që mbahej Kongresi i Lushnjes, qeveria e Durrësit u përpoq me të gjitha mënyrat dhe mjetet për të ndaluar zbatimin e vendimeve të kongresit, duke u mbështetur dhe në forcën e ushtrisë italiane që ishte akoma në Shqipëri.

Po kështu, mbajtja e Kongresit të Lushnjes, konsiderohej prej tyre si një lëvizje aventurierësh dhe ajo u përgatit që të sulmonte forcat qeveritare dhe delegatët që do të vendoseshin me seli në Tiranë, e cila ishte caktuar nga kongresi si kryeqytet i Shqipërisë. Nisur nga presionet e qeverisë së Durrësit, e cila po bënte çmos për mosnjohjen e vendimeve të Kongresit të Lushnjes, shumë nga e delegatët Tiranës, Elbasanit, Kavajës e Shijakut, duke kuptuar se do të sulmoheshin me armë nga forcat italiane të nxitura nga qeveria e Durrësit, shfaqën mendimin që të qëndronin dhe për disa kohë në qytetin e Lushnjes.

ZOGU: TË NJIHET KONGRESI

Mendimet që shfaqën disa delegatë, për të qëndruar në qytetin e Lushnjes deri sa të stabilizohej disi situata anarkike e krijuar nga qeveria e Durrësit, i kundërshtoi hapur Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu. Mes të tjerash ai ju tha delegatëve: "Vendimet e Kongresit do të zbatohen domosdo dhe pa vonesë, kjo gjë lyp guxim dhe punë, prandaj unë po nisem për në Tiranë, ju po të doni rrini këtu". Kështu, siç dhe ishte parashikuar, gjatë udhëtimit të tij për në Tiranë, Ahmet Zogut dhe njerëzve që e shoqëronin, ju pre rruga në Kavajë nga ana e forcave italiane që ishin të armatosura me topa e mitraloza. Një oficer italian ju doli përpara Zogut e njerëzve të tij dhe ju dha urdhër atyre që të ndërprisnin marshimin. Ahmet Zogu e kundërshtoi hapur oficerin italian duke i thënë: "Unë nuk njoh tjetër autoritet, përveç Kongresit të Lushnjes". Pas një debati të ashpër që desh kaloi në konflikt të armatosur, oficeri italian u tërhoq së bashku me gjithë forcat që kishte nën komandë dhe i hapi rrugën Ahmet Zogut që të hynte në qytetin e Kavajës.

Në atë qytet, Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu, qëndroi për disa ditë, duke emëruar nënprefektin dhe disa nëpunës të vegjël të administratës vendore. Hyrja e Ahmet Zogut në Kavajë, e shqetësoi shumë qeverinë e Durrësit, e cila duke e kuptuar që me anë të forcës nuk mund ta ndalonte dot Zogun, filloi të përdorte dredhitë, duke i dërguar atij një delegacion për të hyrë në bisedime. Delegacioni që u dërgua nga ana e qeverisë së Durrësit, i propozoi Ahmet Zogut, që të transferohej kryeqyteti për në Vlorë dhe të thërritej një kongres tjetër kombëtar atje, për të biseduar lidhur me situatën në vend e masat që duhet të merreshin për stabilizimin e situatës në Shqipëri. Mbi këtë propozim, që ju servir Zogut, qeveria e Durrësit, vinte kusht dhe kërkonte anullimin e të gjitha vendimeve të Kongresit të Lushnjes. Pas pak orësh nga vajtja e delegacionit të Durrësit për bisedime me Ahmet Zogun, ai delegacion u kthye shpejt në qytet, pasi Zogu refuzoi kategorikisht, që të bisedonte rreth atyre propozimeve.

Shqipëria ishte njohur si shtet i pavarur, më 1913, por gjysma e saj kish mbetur jashtë kufijve, përbrenda ziente anarkia më e plotë: Kundër Qeverise së Ismail Qemalit në Vlore, mbinte Qeveri e Esad Toptanit në Durrës. Aventurierët e brendshëm menduan se gjeten shesh të bëjnë rrëmujë, ndërsa armiqtë e jashtëm, të pangopur me ato pjesë që kishin rrëmbyer, u sulën mbi shtetin e ri gjysmak me qëllim që ta copëtonin fare: Grekët e shkretuan Toskërinë me zjarr e me hekur, serbët shkelën Shqipërinë e Veriut, malazezët hynë në Shkodër mbas një qëndrese heroike të atij qyteti. Patriotët shqiptarë nuk dinin se nga t'i jepnin. Forcat e errësirës përbrenda ishin të shumta dhe armiqtë e jashtëm ishin tepër të fortë për atë popull të vogël. Një princ gjerman që u dërgua si mbret i Shqipërisë prej fuqive te mëdha, zbriti në Durrës në mars të vitit 1914 dhe u shtrëngua të largohej në shtator të atij viti. Lëvizja e Rebelëve në Shqipërinë e Mesme dhe vërsuljet e grekëve në Shqipërinë e jugut po e bënin të pamundur organizimin e një shteti shqiptar. Në ketë kohë plasi Lufta e Parë Botërore dhe Shqipëria u pushtua prej ushtrive ndërluftuese austro-hungareze, italiane dhe frënge.

Me mbarimin e Luftës Botërore, problemi shqiptar dilte m'i koklavitur akoma: Traktati i fshehte i Londrës (i nënshkruar me 1915) i premtonte Italisë Vlorën me qarkun e saj dhe një fare protektorati mbi Shqipërinë e mesme, mbasi te merrnin greket Shqipërinë e jugut dhe serbo-malazezet atë te veriut. Në baze te këtij traktati, Italia vazhdonte te mbante te pushtuar Vlorën dhe ca krahina te tjera shqiptare duke përkrahur njëkohësisht një Qeveri kukull në Durrës, me ane te se cilës donte te siguronte protektoratin mbi Shqipërinë e mesme. Në vazhdim te kësaj vije politike, nënshkroi me Greqinë, me 1919, marrëveshjen Tittoni-Venizelos, e cila ia njihte Greqisë kërkesat mbi Shqipërinë e jugut me kusht që edhe Greqia ta njihte sundimin italian mbi pjesën tjetër te Shqipërisë. Natyrisht, edhe Jugosllavia, që kish dale nga lufta si fëmije e përkëdhelur e fuqive te mëdha, nuk do te mbetej me duar thate; do te shqyente edhe ajo një cope nga veriu duke përfshire ndoshta edhe Shkodrën.

Këto ishin planet e jashtme mbi Shqipërinë dhe Konferenca e Paqes, që u mblodh në Paris me 1919, kërkonte ta zbërthente problemin shqiptar në mbështetje te këtyre planeve. Gjendja dukej fort e dëshpëruar, shpresat dukeshin te humbura. Shqipëria s'kish asnjë përkrahje te jashtme përveç zërit te fuqishëm te Presidentit ëilson te Amerikës. Presidenti ëilson ish një njëri idealist që besonte në drejtësinë, në përparimin

(Vijon në faqen 7)

MESAZH

100-vjetori i Kongresit të Lushnjes, vendimet e atij Kuvendi mesazh reflektimi

• *Presidenti i Republikës së Shqipërisë SHT Z.Ilir Meta shprehet se Kongresi i Lushnjes rithemeloi shtetin e pavarur, riformatoi institucionet shtetërore dhe vetëqeverisëse të tij*

TIRANË, 21 janar 2020 - Presidenti i vendit Ilir Meta, ka kujtuar sot 100-vjetorin e Kongresit të Lushnjes, duke e cilësuar atë një nga ngjarjet më të mëdha dhe më të rëndësishme në historinë kombëtare, pas asaj të shpalljes së Pavarësisë. Në një postim në "Facebook", kreu i shtetit shprehet se Kongresi i Lushnjes rithemeloi shtetin e pavarur, riformatoi institucionet shtetërore dhe vetëqeverisëse të tij.

POSTIMI I PLOTË I PRESIDENTIT ILIR META:

Kongresi i Lushnjes, 100-vjetorin e të cilit festojmë sot, është ngjarja më e madhe dhe më e rëndësishme në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së Pavarësisë në 28 nëntor 1912 në Vlorë.Kongresi i Lushnjes rithemeloi shtetin e pavarur, riformatoi institucionet shtetërore dhe vetëqeverisëse të tij, krijoi Kushtetutën e parë të vendit, zgjodhi të parën trupë legjislative mbi baza pluraliste, dhe shprehu vendosmërinë e të gjithë shqiptarëve për të mbrojtur pavarësinë, sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Shqipërisë.

100 vjet më vonë, vendimet e këtij Kuvendi Kombëtar janë mesazhe për reflektim, për të ecur në rrugën që hapi ky Kongres, për të mbrojtur Kushtetutën dhe pluralizmin, integritetin e institucioneve shtetërore e në mënyrë të veçantë për të mbrojtur vlerat reale dhe pluraliste demokratike të parlamentarizmit shqiptar.

Koha i thirri burrat e shquar atdhetarë shqiptarë me bindje të ndryshme politike në vitin 1920 për t'i vënë mendjen dhe energjitë e tyre në shërbim të kombit e për të shpëtuar Shqipërinë.Nderimi për ta e për veprën e tyre është sot obligim, por edhe një detyrë që në emër të idealeve që frymëzuan ata, të ecet drejtë për ta bërë atdheun tonë një vend të qëndrueshëm dhe frymëzues për brezat e rinj, që të ndërtojnë të ardhmen e tyre, në një Shqipëri demokratike dhe anëtare të Bashkimit Europian.

Sot festohet 100-vjetori i Kongresit të Lushnjes, një prej më të rëndësishmëve në historinë e kombit tonë shqiptar. Kongresi i Lushnjes ka zhvilluar punimet që prej datës 21 deri më 31 janar të vitit 1920. Ky kongres ka luajtur rolin më të rëndësishëm në historinë e kombit shqiptar, pasi qëllimi i mbajtjes së këtij kongresi ishte mbrojtja e tërësisë territoriale të Shqipërisë, rimëkëmbja e shtetit shqiptar dhe sigurimi i pavarësisë së tij. Në këtë kongres kanë marrë pjesë rreth 50 përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë.

100-vjetori – Kongresi i Lushnjës ngjarje madhore në historinë tonë kombëtare

(Vijon nga faqja 6)

moral te njerëzisë dhe parimet për te cilat vendi i tij kish hyre në lufte u mundua t'i mbronte gjer në fund. Presidenti ëilson ish një nga te rrallët burra shteti që atë çka flasin e kane megjithe mend dhe që e përdorin gjuhen, jo për sofizma e dredhira, por për te shpallur te vërtetën. Mire po ç'mund te bënte ëilsoni sikur shqiptaret te mos ishin te zote te lëviznin vete? Amerika s'mund te dërgonte ushtri në Evrope për te siguruar pavarësinë e Shqipërisë. "Duhet te shpresoni në veten tuaj", iu ish përgjigjur ambasadori i Amerikës, në Paris, disa patrioteve shqiptare që kishin vajtur ta shihnin dhe që i thane se te tera shpresat i kishin varur tek Amerika.

Cila ishte gjendja e Shqipërisë përbrenda? Një rrëmuje, një kaos ku se merrte vesh i pari të dytin. Italia mbante të shkelur ushtarakisht një pjesë të vendit dhe përkrahte një Qeveri kukull, e cila dërgonte delegacione në Konferencën e Paqes. Jugosllavët ishin në Dibër dhe herë-herë nuk përtonin të zbrisnin më poshtë. Grekët nga jugu futnin fite dhe bënin ngacmime. Shqiptarët përbrenda s'dinin nga të mbroheshin më parë as dinin nga të faleshin. Shqiptarët e kolonive dërgonin në Konferencën e Paqes delegacione, që vinin shpesh herë në kundërshtim me atë të Qeverisë së Durrësit. Esad Toptani ndodhej në Paris, në qendër të intrigave që thurnin armiqtë e Shqipërisë. Si mund të dilej nga kjo gjendje e turbullt? Si mund të vihej një rregull në mes të këtij kaosi? Në këto rrethana u mblodh Kongresi i Lushnjes, më 21 janar 1920, si një shfaqje e vullnetit kombëtar, si një akt trimërie në mes të dëshpërimit. Përfaqësuesit e krahinave, që u mblodhën në Lushnjë nga të gjitha anët e Shqipërisë, ishin të vendosur të bënin bashkimin kombëtar, t'i jepnin fund anarkisë, të ndërtonin një shtet shqiptar të përqendruar mbi forcat e tij dhe të pavarur. Kjo ishte e vetmja rrugë shpëtimi. Por kjo u prishte planet atyre që vepronin si agjentët e të huajve dhe që kishin varur shpresat e ambicieve të tyre tek të huajt. Prandaj disa anëtarë të Qeverisë së Durrësit shtinë e vranë Abdyl Ypin që ishte një nga iniciatorët e Kongresit.

Megjithatë, Kongresi nuk u tund as nga këto kërcënime as nga vështirësitë e gjendjes. U shpall si një Kuvend kombëtar i plotfuqishëm, i tregoi botës se Shqipëria ish e pavarur dhe e pandashme dhe iu përvesh punës për organizimin e shtetit shqiptar. Intrigat dhe kanosjet e fqinjëve e kishin neveritur popullin aq shume sa që ky e pa Kongresin si një forcë shpëtimi dhe e brohoriti me tërë entuziazmin nacionalist të asaj kohe. Duke iu dale kundër intrigave të jashtme dhe planeve të copëtimit që bëheshin në Konferencën e Paqes, Kongresi i Lushnjes nisi të veprojë si i vetmi autoritet i Shqipërisë, me fuqi sovrane: Hartoi statutin e shtetit shqiptar me një Këshillë të Naltë në krye, zgjodhi Tiranën për kryeqytet dhe i dha vendit një Qeveri të ligjshme, e cila iu vu me energji organizimit të administratës, të xhandarmerisë, të shkollave dhe u mundua t'i jepte fund anarkisë. Në pak kohe, Qeveria e Tiranës, e dalë nga Kongresi i Lushnjes, u njoh prej të gjithë shqiptareve dhe u formua kështu një qendër rreth së cilës mund të mblidheshin energjitë e kombit.

Ndërhyrjet e huaja vazhdonin akoma: Italia mbante të pushtuar ushtarakisht Vlorën dhe qarkun e saj gjer në Tepelenë; jugosllavët mbanin Dibrën dhe nganjëherë patën zbritur deri në shkallët e Tiranës; grekët vazhdonin këngën e vjetër për Korçën dhe Gjirokastrën. Por tani kish të paktën një qendër shqiptare që mund të kanalizonte përpjekjet e kombit. Kongresi i Lushnjes kish ngjallur shpresa dhe iu kish dhënë shqiptarëve një farë besimi në vetvete. Aq sa, pa marrë parasysh përpjesëtimin e forcave, rrethet e Vlorës e të Labërisë dhe pastaj e tërë Shqipëria e jugut u ngritën me arme në dorë kundër ushtrisë italiane, të cilën brenda pak muajve e shtrënguan të tërhiqet dhe të lëshojë Vlorën. Disa përpjekje kundër serbëve në veri, tregonin të njëjtin vullnet lirie dhe pavarësie. U duk edhe njëherë se shqiptarët e bënë fora.

Tërheqja e Italisë nga Vlora sillte si rrjedhim logjik pavarësinë e shtetit shqiptar. Pse në qoftë se gjer atëherë kish pasur për Shqipërinë një rrezik copëtimi, ky vinte më fort nga ndërhyrjet e Italisë se sa nga fqinjët ballkanas. Këta të fundit mund të ngulnin thonjtë mbi tokat shqiptare vetëm atëherë kur Italia ta mohonte pavarësinë ose tërësinë tokësore të Shqipërisë duke e përmbysur ajo vetë ekuilibrin në Adriatik dhe në Ballkan. Sikur Italia të vendoste njëherë e përgjithmonë se një shtet shqiptar i pavarur është i nevojshëm për sigurimin e saj dhe në vend të një politike imperialiste copëtimi ose kolonizimi, të kërkonte me kombin shqiptar marrëdhënie miqësore me pajtim interesash të të dy palëve, fqinjët e Ballkanit i binin kavallit kot. Ajo që ka venë në rrezik ekzistencën e Shqipërisë që prej traktatit të fshehtë të Londrës (1915) dhe gjer në ardhjen e komunistëve në fuqi, nuk kanë qenë aq fort fqinjët ballkanas se sa qëndrimi i lëkundshëm i politikës italiane. Ndërrimet e herë mbas hershme të politikës italiane kundrejt vendit tonë i kanë sjellë Shqipërisë dëm më shumë ndoshta nga barbarizmat e fqinjëve ballkanase (Por sigurisht Italia e sotme e ka kuptuar këtë të vërtetë). Pra, me tërheqjen e ushtrive italiane nga Vlora, më 1920, Shqipëria mbetej automatikisht shtet i pavarur. Dhe si i tillë u pranua në gjirin e Lidhjes së Kombeve që në shtator të atij viti. Një vit më vonë, më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve në Paris, i hodhi poshtë kërkesat e grekëve mbi Korçën dhe Gjirokastrën dhe Lidhja e Kombeve nisi të vëzhgoi lëvizjet e jugosllavëve.

PROFIL

Me dhanë pushkën pa luftue/...ma mirë vdekë se me u marrue...”! (VISARET E KOMBIT
Tiranë, 1939 / IV, f.88)

Mark Deda - PLAKU
LEGJENDAR I BJESHKËVE TONA

Nuredin LUSHAJ
Studiues

Mark Deda (1840-1910) është dëshmori i parë që Berisha dhe Puka dhanë për liri e Pavarësi. Ai është pinjoll i një prej kullave të Malësisë, që bijtë e saj kanë lënë histori të lavdishme ndër breza në luftë për liri e pavarësi me pushtuesit osmanë, serbë e malazezë, duke ia kushtuar jetën atdheut tonë të dashur. Kullë e cila gjendet në lagjen Belshina të fshatit Berishë të rrethit të Pukës, kontributi i së cilës për liri e pavarësi Kombëtare shtrihet që nga koha e Tanzimatit.

Mark Deda (Dëshmor i Atdheut), nga martesa e tij me Lenën, bijë Toplane nga dera e Dedë Kolës kishte tre djem: Ndoc Mark Deda (Dëshmor i Atdheut); Mëhill Mark Deda (Dëshmor i Atdheut); Gjergj Mark Deda (Qytetar Nderi Komuna Iballë).

Marku, u rrit në Berishë në luginën e Drinit, në zemër të maleve kreshnike shqiptare, në një prej zonave të njohura për bujari, trimëri dhe atdhetari, që u bënë virtyt i formimit të tij, shembull për brezat pasardhës. Marku, ishte bashkëmbrojtës i traditave në autonominë e maleve që prej zbatimit të Reformave të Tanzimatit.Ai nuk u tërhoq nga idealet për liri e pavarësi as nga presioni i madh që ushtronte Porta e Lartë.

Mark Deda bashkë me trimat e tjerë të zonës, u bë përkrahës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e trojeve shqiptare deri në Plavë e Guci dhe të udhëheqësve të Lidhjes, Dega Pukë, si Ismail Agë Kryeziu, Musa Puka, etj. Edhe në vitin 1882-1885 Mark Deda merr pjesë në kryengritjen për lirimin e krerëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Xhemal Meçi, Gazeta “Koha Jonë” Tiranë me 04 .06. 2016, f.14) Musa Puka, Ismail Agë Kryeziu (Dekoruar për veprimtari patriotike me 1978) kryengritje e organizuar nga Mustaf Agë Kryeziu, etj. (Dokomentat arkivorë Nr3/1Prot.,datë 18.08.2014 dhe Nr.5/2Prot., datë 04.03.2016, Muzeu Historik Pukë) me qëndrimin e tij të guximshëm, tëhoqi rreth vetes luftëtar liridashës me të cilët u bë simbol i qëndresës në viset për rreth Drinit, në anën veriperëndimore të Pukës e jashtë saj.

Luftrat e pareshtura të malësorëve kundër pushtuesit osman tregonin revoltën e tyre në rritje në shkallën më të lartë të ndërgjegjësimit kombëtar për liri e pavarësi. Megjithatë pushtuesit Osmanë nuk hoqën dorë për shtypjen e këtyre kryengritjeve dhe çarmatosjen e popullit. Për këtë qëllim ata dërguan herë pas here ekspedita të dhunëshme të cilat ushtronin terror ndaj banorëve dhe kërkonin çarmatosjen. Në këtë periudhë të vështirë e plot rreziqe djaloshi trim i berishës, Dëshmor i Atdheut Ndoc Mark Deda, duke kaluar fshatrave e lagjeve të Berishës, duke shprehur edhe mendimin e vendosur të popullit , deklaroi haptas se “nuk do t’i dorëzoj armët për së gjalli”. Më 1910, kur u kërkua me forcë zbatimi i ligjeve të Qeverisë Xhon Turke, Ndoci, prijësi i një prej çetave të kësaj zone, nuk pranoi, as taksa, as çarmatosje, as nizamërinë , detyrim ushtarak. Në Korrik të këtij viti, me ardhjen në Pukë të Shefqet Turgut Pashës në krye të një ushtrie të madhe, u bë presion i fortë ushtarak për dorëzimin e armëve që mbaheshin në popull. Në ato zona ku kishte prijës, si në Berishë: Ndoc Mark Deda i cili kishte rënë në sy nga pushtuesit si drejtues çete, organizues dhe prijës popullor, kundër pushtuesit, mblidhnin burrat dhe në qendër të fshatit i torturonin egërsisht, si e si që fshatarët nëpërmjet keqtrajtimit e dhunës të dorëzonin prijësit e çetave. Kur nuk ia arrinin qëllimit as kështu, merrnin masa të tjera me anë të xhandarmërisë e prej forcash ushtarake që t’i ndiqnin kudo duke përdorur edhe pabesira e pusira nga më të ndryshmet. Në këto kushte Ndoci së bashku me dy vëllezërit e tij Mëhillin dhe Gjergjin u arratisën në mal. Arratia në këto kohëra të vështira që po kalonte vendi ishte bërë një dukuri e zakonshme, por pas disa muajsh arratije, ata vendosën që të ktheheshin në shtëpi me datën 5 dhjetor 1910 pasi ishte një “Natë e Madhe” dhe populli e festonte sipas traditës Natën e Shënkollit, por një spiun, kishte njoftuar xhandarmërinë duke thënë se “Ndoci gjendej në shtëpi”. Kështu pa vonuar Kulla u rrethua nga forca të shumta ushtarake e të xhandarmërisë, të armatosura me mjetet luftarake më të mira të kohës. Ndoci vet i treti vëlla: me Mëhillin ,Gjergjin dhe babë Markun, vendosën së bashku që kurrësesi të mos dorëzoheshin. Luftimet filluan dhe forcat armike qëllonin mbi shtëpi nga të gjitha anët, por Ndoci doli me të shpejtë përmes të shtënave të armëve të zjarrit të forcave pushtuese duke hapur një front të ri në sulmin ndaj armikut, të cilët po qëllonin mbi shtëpi pa pushim, ai për të dalë u ndihmua edhe nga pema e manit e cila ndodhet në cep të shtëpisë dhe i shërbeu si mburojë i cili nga plumbat dhe gjylet e topave gjysma e tij më vonë u tha dhe gjysma tjetër ruhet edhe sot, i cili njihet si “Mani i Ndoc Mark Dedës”.

Me hapjen e frontit të ri të luftimeve nga Ndoci u zhvillua një betejë tepër e ashpër jehona e armëve ushtuan në luginën e Drinit, trimat nuk u mposhtën, por goditën pa pushim armikun, aq sa në kampin e zaptive filloi tërheqja në panik duke marrë mbi shpinë trupat e viktimave dhe të plagosurve të tyre, ndërsa Ndoc Mark Deda me vëllezërit e tij dhe pjesëtarët e çetës që i erdhën në ndihmë si Mehmet Ali Doçi, Demë Prendi, Koc Marku (ish korrier i Bajram Currit), Vëllezërit Koliku, Vat Martini i ndoqën zaptitë më luftime në mbi 2km, deri te “Lisi i Lekës”. Gjatë kësaj beteje u plagos Ndoci me të dy vëllezërit e tij Mëhillin dhe Gjergjin, ndërsa i ati i tyre Mark Deda gjatë luftimeve ra dëshmor në moshën mbi 70 vjeçare, dëshmori më plak i çetës. Porosia e fundit para vdekjes e atdhetarit trim Mark Deda për të bijtë që: “Për të gjallë mos me u dorzue, / por me vdekë tuj luftue !”

Nga ana e armikut pati tetë të vrarë mes të cilëve edhe Çaushi (Komandati i garnizonit ushtarak) si dhe të plagosur të shumtë. Ndoc Mark Deda e kishte paralajmëruar prej kohësh “Hyqimetin” (Përfaqësuesi i qeverisë osmane, i Portës së Lartë) se Berisha nuk i dorëzon armët për së gjalli dhe se po t’i kërkojë ndokush ato, do të gjakosej nga dora e popullit të saj.

Këto luftime krejt të pabarabarta me forcat armike, ishin traditë në këto male siç tregon Frang Bardhi në vitin 1638 kur e vizitoi zonën e Iballës dhe Berishën i cili shkruante: “...N’Evropë nuk gjendën as nuk janë gjetur trima si këta, që kaq rrënim t’u kenë sjellë osmanëve “... besohet se në Evropë nuk gjendën burra armësh më të mirë se këta kundër armikut. Burrat e kanë për nder të vriten sidomos me ushtri të mëdha, një i vetëm shkon me guxim e futet në mes të 15-20 ushtarëve armik, jo së largut e me zjarr, jo fshehurazi, por ballë për ballë, me siguri gjë e pabesueshme për ata që nuk e dinë.

Këtë ngjarje epokale të qëndresës sonë kombëtare, sado me humbje dhe pasoja, gjatë së cilës Ndoci tregoi guxim e vendosmëri, duke dhënë shembull në komunitet, duke u bërë simbol i qëndresës Shqiptare, dhe nje

(Vijon në faqen 9)

MARK DEDA
(Dëshmor i Atdheut)

IN MEMORIAM

PROF. DR. DAVID LUKA, studiuesi i përmasave akademike të gjuhësisë së shqiptarisë

XHEMAL MEÇI
Studiues , "Mjeshtër i Madh"

Pse vdekja e këtij kollosi të studimeve Gjuhësore Shqiptare u la disi në heshtje?!!! Duke e parë këtë heshtje të pakuptimtë, e ndoshta të qëllimtë, më në fund ishte Radio Vatikani, që dha lajmin e kobshëm: "Ndërroi jetë në Shkodër Prof. Dr. David Luka, vëllai i kolegës Ana Luka". Edhe në Pukë ky lajm shkaktoi shumë dhëmbje sidomos te studiuesit dhe intelektualët Pukas.(Xh. Meçi, Mark Mesuli, Idriz Ahmetaj, Fran Vukaj,Kolë Deda, Ramazan Ringaj,Gjovalin Alia, Riza Hoxha,Angjelin Marku, Gjovalin Meta etj.) Njoftimi tepër I vonuar , nuk u dha mundësi disa prej këtyre të merrnin pjesë në homazhet mortore panë familjes së Tij, të të ndjerit, Shkodër, 14 janar 2020, ditën e varrimit. Ka mundësi që të na ndihmonte edhe kryetari i Bashkisë Pukë, z. Gjon Gjonaj , i cili është mjaft i ndjeshëm për raste të tilla, siç veproi me të ndjerin Idriz Meti, më 21 nëntor 2015, Qytetar Nderi I Bashkisë Pukë dhe Lezhë, ku kishte milituar e punuar, ish -partizan, kuadër i pushtetit vendor Pukë, Zadrimë e Lezhë etj. (Sapo Grupi organizues e i shoqërimit të arkivolit të tij nga Elbasani për në vendlindje, Qerret të Pukës (Dr. Sulejman Sula, Arif Cena,Muharrem Nezir Cufaj,P. Alia etj), më kërkuan që të njoftoja Bashkinë për ceremoninë e një homazhi në mjediset e saj. Z. Gj. Gjonaj menjëherë mori masat e duhura aq sa qytetarët e Pukës e pritën mjaft mirë këtë akt human e vlerësues me këtë homazh të merituar. Kështu edhe për rastin e

prof. dr. Davidin mund të na siguronte automjetin e Tij dhe kurorën e luleve si respekt nga Puka e Qarkut Shkodër, siç veproi edhe ish-kryetari i Bashkisë Pukë z. Ndue Cara/ më 22 shtator 2003, kur ndërroi jetë prof. dr. Jup Kastrati duke na dhënë automjetin e Tij , kurorën me lule , të shoqëruar me komandantën e policisë bashkiake Pukë, oficerën, Afërdita Hadroi, që ia shtonte aq shumë bukurinë e hijeshinë natyrale,uniforma e saj e re e policisë. Kështu me atë pjesëmarrje Puka nderoi veten dhe të ndjerin prof. dr. J. Kastratin. Rektori I Universitetit, prof dr. Mahir Hoti qëndronte para Rektoratit pranë arkivolit në afërsi të familjes së të ndjerit,duke pritur e përcjellur vizitorët e shumtë. Ndërsa tani krejt ndryshe veprohet me prof. dr. David Lukën e famshëm.

Më habiti dhe më shqetësoi një indiferentizëm i tillë që nga ish-kolegët e Tij të Universitetit, katedra e gjuhës shqipe, Rektorati deri te Bashkia dhe Këshilli i Qarkut,Akademia e Tiranës bashkë me institucionet shkencore të saja, se e kasha mik e më priste si kolegë sa here i trokisja ë derë për ndihmesën e Tij shkencore.

Prandaj pyes I zemruar: Ku humbën vallë gjithë ata intelektualë e drejtues?!,ku?! Si jua lejoi ndërgjegja një qëndrim të tillë,kur kortezhi familjar ecte i vetmuar për në varreza,ku u dëgjua vetëm zëri i priftit të kishës1 O ju intelektualë Shkodranë e të Shqipërisë mbarë?! Si do t'ju përgjigji gjuhëtarëve Ulqinakë eKosovarë,Maqedonas e Arbëreshë dhe të mbarë Diasporës, Si!!!? Vetë Ai e citon në letrën drejtuar Rektoratit (USHLGJ), më 14 shkurt 2010 (botuar në "Studime Gjuhësore. Shkodër, 2010, f.231) , kur kërkonte të jepte leksionet e Tia në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", gjë për të cilën "asnjëherë nuk u pranua kërkesa e përsëritur imja për t'u pranuar si pedagogë efektiv" në atë Universitet,që e kishte thuajse te pragu i derës. (!)

Dhe ja si përgjigjigjet i revoltuar dhe disi i fyer,me një farë autoportreti (SV) të shkurtër të Tijën vetë Profesor Davidi: mbaj dy tituj: "Profesor" dhe "Mësues i Popullit", si dhe gradën shkencore "Doktor në fushën e gjuhësisë", megjithëse kam botuar 11 vëllime "STUDIME GJUHËSORE"; kurse deri në fund të jetës së vetë arriti në 20 vëllime të tilla), megjithëse ; kam botuar ndër revistat periodike (të vendit dhe të huaja114 artikuj shkencor..., megjithëse më kanë përfshirë në "FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR", TIRANË; 2008, (f.1568)…,megjithëse Q.S.A.SH.(Qendra e Studimeve Albanologjike)shqiptare po ma boton për së gjalli veprën time. Atëhere pse?! Sepse ishte "mall kaurri " për eprorët mediokër e fodullë, sepse ishte kundër lajkave e servilizmit, gjë që nuk e pranoi as në kohën e diktaturës prandaj, e pushuan tri herë nga puna si mësues deri sa e caktuan edhe punëtorë në kovaçhane dhe e transferuan mësues deri në Orosh e Malësi , 20 vjet "mësues fshati", por "i pabindur e i panënshtrueshëm",duke mbetur DAVIDI jo me sy përdhe por kryelartë(!) por gjithmonë me mendje e zemër te Studimet Gjuhësore, që asnjëherë s'i lshoi prej doret.

Ndërsa aq shumë vlerësime shkruajnë për te Profesorët e nderuar si profesor Jup Kastrati, Kolec Topalli etj. Në veçanti të akademikut Prof. Shaban Demiraj, i cili i drejtohet si koleg e si mik: "... Uroj që vullneti i paepur për punë hulumtuese, që Ju ka karakterizuar gjatë tërë jetës ,të sjellë në dritë edhe vepra të tjera në të ardhmen, sepse vetëm me ndihmat e shumanshme të studiuesve shqiptar dhe të huaj do të mund të ndriçohen siç duhet çështjet e shumta të historisë së gjuhës shqipe të sistemit fonologjik dhe të struktures gramatikore të saj… Dhe unë vërej me kënaqësi që Ju përpiqeni të jepni ndihmesën tuaj e të mos kënaqeni vetëm me ç'është thënë deri më sot". Po si mund të justifikohet Shkodra për heshtjen e vet për ceremonialin e nderit që ia mohoi?! Tani do të mjaftohemi duke përmendë disa vargje që shkroi studentja e vitit të pestë për arkitekturë në UP Tiranë, kur ishte këto ditë në Shkodër për të kërkuar ndihmën e studiuesit të mirënjohur Agron Luka për disa harta e materiale të tjera, mbasi i duhen për Mbrojtje diplome me temë SHKODRËN, se këtë vit diplomohet inxh. Arkitekte:" O ju vasha Shkodrane me ato sy të bukura që dini me kja! / Ejani e vajtoni burrninë e shkretë , në të cilët Shkodra sot paska mbetë!/ Që heshti për vdekjen e profesorit të vërtetë. / Që 20 botimet e veprës së Tij Ty t'kanë mbetë!Ty ta ka lanë, si pasuri e paçmuar për GJuhësi e Shqiptari! O burra e gra të Shkodrës së ndjerë ! A e dini se 20 libra shkencore lartësohen me Alpet Shqiptare dhe janë pasuri sa këto hidrocentrale! "Po pyet Mirdita atje në mal:"Po Gjysepina ku paska qanë?! Se mbet mbas karrikes atje n' Tiranë,qysh se pate e kanë pasë lanë! "Ti e di se Profesor Davidin krah e ke pasë gjithë këto vite të Demokracisë, /Duke të përkrahur si vajzë e shtypur e tiranisë! !)

/ Tani, ju vasha të bukura boll keni kja! për Profesor Davidin që e la pas këtë dynja! E iku në at arkivol i mjeruar tuj fsha! Për këtë përcjellje me këtë hata!"

A mund të ndreqet ky gabim i rëndë?! Them se po, veçse me festimin përkujtimor të 85-vjetorit të lindjes së Tij, më 15 maj 2020, (1935-2020) me një bashkëpunim të përbashkët brenda e jashtë Shkodrës.

Mark Deda - PLAKU LEGJENDAR I BJESHKËVE TONA

(Vijon nga faqja 8)

figure e pavdeksehme e vetmbrojtjes Shqiptare, gjë që aq mirë e portretizon "Artist i Merituar" Prendush Gega, bashkëkohës i zhvillimit të ngjarjes në një prej këngëve më të fuqishme të krijimtarisë së tij: "N'at Stamboll po kndon gazata / si nap armët sa të jetë jeta / sa të jetë jeta armët si jap / për pa i la zaptit me gjak…."

Kenga e Ndoc Mark Dedës është kënduar aq shumë me një shtrirje që nga Shqipëria, Kosova si dhe në të gjitha trevat ku flitet shqip deri SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) prej emigrantëve që jetojnë atje. Për më tepër, Festivalin Folklorik Kombëtar Gjirokastër, 1983, ansambli artistik i Pukës e ka hapur programin me këngën e Ndoc Mark Dedës. Në këtë festival prej dekadash zbrisnin aty nga brenda e jashtë Atdheut me një bukuri të rrallë veshjesh dhe entuziazëm mahnitës, shoqëruar me veglat muzikore të gjithfarshme, grupet më të mira të ansambleve folklorike për konkurim. Gjithashtu edhe ansambli "Rugova" i Kosovës ka bërë hapjen e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 2009 me këngën e Ndoc Mark Deda e përzgjedhur prej tyre pasi këngëtari Kosovar, Bajrush Doda me këtë këngë kishte sukses të jashtëzakonshëm në mbarë Kosovën duke e ngritur publikun në këmbë me brohoritje (Xhemal Meçi, "Poeti i Kabashit", Puka që në lashtësi - 6,Tiranë 2014, f.201-202; f.202-203; f.233-236). Jeta dhe veprimtaria patriotike në shërbim të atdheut e Mark Dedës është vlerësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes Komisionit Qendror të Statusit " Dëshmori i Atdheut", me vendim Nr.708 datë 11 Janar 2017 duke e shpallur atë "Dëshmor i Atdheut", dhe familjes së tij i jep simbolin "Familje e Dëshmorit të Atdheut" .

Simbolet "Familje e Dëshmorit të Atdheut, për Dëshmorit e Belshinës: Mark Deda, Ndoc Mark Deda, Mëhill Mark Deda, Certifikata "Qytetar Nderi" i Komunës Iballë e Gjergj Mark Dedës, si dhe fotoportretet e tyre të përgatituar nga piktori Mahmut Gashi, ruhen nga pasardhësi i tyre, studiuesi, Inxhinier Kol Dedaj, Qytetar nderi Bashkia Pukë, autor i disa librave e botimeve. Në përgaditjen e këtij shkrimi modest për lexuesin u mbështeta në materjale arkivore si dhe në shkrimet e historianit Xhemal Meçi (Mjeshter i Madh) në botimet e mija të mëparëshme, etj., për këtë bërthamë e simbol të vetëtdijes sonë kombëtare. Në mbyllje bashkangjitur gjëndet një poezi, për këtë pishtar të trojeve tona iliro-arbnore-Shqipëtare me titull:Plaku legjendar i bjeshkëve tona.

STUDIMI

Me rastin e 148 vjetorit të lindjes dhe 79 vjetorit të vdekjes

EMRI I GJERGJ FISHTËS DHE JEHONA E LAHUTËS SË TIJ DO TINGËLLOJNË PËR JETË MADHËRISHËM MES SHQIPTARËVE

SHPENDI TOPOLLAJ

Kur rreth katër shekuj më parë, i linduri në të njëjtën trevë, dhe i ngjashmi me Fishtën, kleriku, historiani, etnografi dhe gjuhëtari Frang Bardhi, i drejtohej një prelati në Romë me fjalët profetike: "Pashë zemrën e Krishtit, të mos na dërgoni ma ipeshkvij në këto anë që të jenë prej kombit sllav", duket se paralajmëroi jo vetëm domosdoshmërinë e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare, por edhe lindjen e një gjeniu, i cili me kryeveprën e tij "Lahuta e Malcisë", njëzëri u quajt "Homeri shqiptar". Dhe ndofta më saktë e përcaktoi, i dituri Ernest Koliqi që e identifikoi atë si "interpret i shpirtit shqiptar". Autor i një sërë veprash madhore poetike si "Mrizi i Zanave", "Vallja e Parrizit", "Anzat e Parnasit", "Gomari i Babatasit" etj., ky themeluesi i gazetës autoritare "Hylli i Dritës", ky kontribues i madh në gjuhën tonë dhe në çështjen kombëtare si politikan, pas një pune 35 vjeçare, botoi të plotë kryeveprën e letërsisë tonë, "Lahutën" në vitin 1937, pra vetëm tre vjet para vdekjes. Madje, për vlerat e jashtëzakonshme të saj, ai mbetet shqiptari i parë i propozuar për çmimin "Nobel". Ndërthurrja madhështore e historikes me mitiken nga pena e tij gjeniale, u bënë shpejt pronë e të gjithë popullit tonë, pikërisht në kohën kur ai kishte më shumë se kurrë nevojë për të. 16.838 vargjet e alternimit të krijimtarisë epike popullore me talentin krijues të vetë autorit, ishin dhurata më e vlefshme dhe më ndikuese që vetë shqiptarëve ju bë, dhe sikurse shprehet Patër Anton Harapi në tekstin "Shqiptari i madh", "...edukoi edhe të huejtë për Shqypni, d.m.th. bani, qi edhe të huejtë të kishin nderim e interesë per gjuhë, per zakone e per gjithshka i përket çashtjes shqyptare". Kjo "pomendore kombëtare" e ngritur mbi 30 këngë që i bëjnë mrekullisht artistikisht jehonë, ngjarjeve tona gati 500 vjeçare dhe që na bëjnë të ndihemi krenar, e shkruar aso kohe, sikurse thotë vetë poeti kur "Shqipëria ish bërë, tani duhej të bëheshin shqiptarët", njohu lavdinë dhe anatemimin e saj, si rezultat i mbrapështive politike, dhe jo vetëm që asaj nuk mund t`i përmendej emri, por edhe vetë Fishtën e vdekur, do ta zhvarrosnin dhe do t`ia flaknin eshtrat në lumin Drin. Dhe pse i gjithë ky mllef ndaj atij që kërkonte marrëdhënie me SHBA? Apo ngaqë kishte shkruar kundër turkoshakëve dhe mizorive të serbo - malazezve dhe që kishte kërkuar gjithmonë pavarsinë e vendit të tij, dhe që thosh: "Pse s`t`a njof asnji per be: / Un Shqyptar, ata janë Shkje: / Ne na dan nji gjak e i`fe: / N`mni t`shoqishoqit kemi le: / Kem` ndermjet nji qiell e i`dhe!..." Pra, paradoksalisht u dënua me harrim ky atdhetar i pashoq, me pretekstin se ishte zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Italisë. Por nuk e harroi kurrë atë ndërgjegja e popullit, e cila e ruajti me dashuri e fanatizëm thellë në zemër, të gjithë veprën e atij që e përcollën në varrim me aq nderime, duke e quajtur "mësues i të gjithë shqiptarëve", "flamurtar i kombit", dhe "poeti ma i perzemert i këtij populli". Po cila qe jeta e Gjergj Fishtës? I lindur në fshatin Fishtë të Lezhës më 23 tetor 1871, me baba Ndokën dhe nënë Prendën, si më i vogli i pesë fëmijëve, dhe me emrin fillestar Zef, ai ishte vetëm shtatë vjeç, kur klima atdhetare sa vinte e po rritej, pas poshtërsive si të Traktatit të Shën Stefanit, ashtu dhe të Konferencës së Berlinit, ku vendi ynë ishte kafshuar si mos më keq, nga orekset e pa ngopura të fqinjëve dhe paturpësisë hileqare të Fuqive të mëdha, çka shpuri burrat e shquar në mbajtjen e Lidhjes së Prizrenit. Ishte pagëzuar nga një prift françeskan që ishte dhe poet dhe që quhej Leonardo Di Martino, dhe qysh i vogël ishte dalluar për shkathtësi e zgjuarsi. Binte në sy zelli për dije i Zefit në Kolegjën e Troshanit që qe çelur qysh në vitin 1880. Ndaj një tjetër prift italian, Atë Marjani, meshtar i Famullisë së Troshanit, duke nuhatur vlerat e këtij djaloshi, me lejen e prindërve e dërgoi atë në shkollën Françeskane të qytetit të Shkodrës. Françeskanët, nga ana e tyre ishin anëtarë të urdhrit katolik që e kishte krijuar Francesko d`Asissi nga provinca e Umbrias në fillim



të shek. të XIII - të dhe që e kishte nisur veprimtarinë e vet humanitare si ndihmës për lebrozët, ashtu dhe ndaj atyre që ishin penduar. Në vitin 1886, gjashtë nxënësit më të mirë, mes tyre dhe Zefi, dërgohen për të vazhduar studimet në kuvendin e Guçjagorës në Bosnje dhe pikërisht këtu sipas rregullave që praktikoheshin, ai ndërroi emrin, dhe nga Zef e ktheu në Gjergj. Me emrin e heroit tonë kombëtar, ai lëvizi në kuvende të tjera dhe filozofinë e përvetësoi në Sutiskë, kurse teologjinë, në Livno. Rol të rëndësishëm, në edukimin e kulturimin e tij, dhe në arritjen e rezultateve shumë të mira, luajtën mësuesit që gjeti atje dhe që i kishin kryer shkollat në Romë e vende të tjera me tradita. Në studimin e tij "Zani i Shna Ndout" A. P. Bardhi thotë se "në Bosne i xuni edhe shllimet e para e dashnin e parë ndaj atdhen" dhe se këtu "filloi pikë së parit me qitë vjerrsha". I tërheqin vëmendjen poetët rrëfimtar At Ndreu Kaçiq dhe At Gega Martiq, por po ashtu studion edhe poetët klasikë si latinë ashtu dhe ata italianë. Nga ana tjetër, nuk resht së ndjekuri nga afër poezinë tonë popullore, të cilën pas një pune plot përkushtim, mjeshtërisht do t`ia kthejë po popullit. Kur së bashku me ata shokët e tjerë, fretërit e parë shqiptar, i kryen studimet në Bosnje, dhe kthehen në atdhe, Gjergjit i ngarkohet detyra e meshtarit. Data 25 shkurt e vitit 1894 është ajo, kur ai mbajti në kishën e Troshanit, meshën e parë, ku dhe kreu detyrën si profesor në këtë Kolegj Françeskan. Më pas caktohet si famullitar në Gomsiqe, Abacinë e Mirditës, ku duke u qëndruar pranë banorëve të atjeshëm, pasuroi dijet e tij me visaret e folklorit, të cilat i përdori gjatë strukturimit të veprës së tij, e sidomos "Lahutës". Studiuesi i nderuar Robert Elsie, në shkrimet e tij tregon se tani nis dhe bashkëpunimi i tij me intelektualë me emër si abati Preng Doçi, dom Ndoc Nikaj, Pashko Bardhi etj. Dhe nisin gjithashtu edhe përpjekjet për të themeluar shoqërinë letrare "Bashkimi" që synonte për të zgjidhur përfundimisht çështjen aq të rëndësishme të alfabetit. Pak kohë më vonë, falë cilësive të veçanta të tij, Fishta emërohet sekretar i Komisarjatit General të Misjonit Françeskan të Shqypnis dhe Drejtues i Shkollës Françeskane në Shkodër. Ishte i pari drejtues shqiptar në një shkollë ku përdorej gjuha shqipe. Nën drejtimin e tij shkolla pati ecje përpara dhe numëri i nxënësve u rrit ndjeshëm, siç u rrit edhe vetëdija kombëtare e tyre. Si rezultat i rritjes së kësaj vetëdije në shkallë vendi, në datat 14 - 22 nëntor 1908 u mbajt në Manastir, Kongresi i famshëm, ku Fishta, tashmë i burrëruar, mori pjesë aktive si përfaqësues i shoqërisë "Bashkimi". Vetë Fishta u caktua që të drejtonte komisionin për zjedhjen e alfabetit, nga ato të propozuarat dhe dihet përfundimi; miratimi i atij latin që ishte dhe i "Bashkimit" . Pasi botoi revistën letrare, folklorike, politike dhe historike "Hylli i Dritës" dhe kreu dënimin për të mërguar 20 muaj, ai në vitin 1916, drejtoi gazetën "Posta e Shqypnies" dhe me patriotë si L. Gurakuqi, N. Mjeda, M. Logoreci etj. organizuan Komisin Letrare të Shkodrës që kishte si qëllim unifikimin e gjuhës tonë. Ndërsa, kur autoritetet urdhëruan mbylljen e "Posta e Shqypnisë", populli i qytetit në gjashtë vjetorin e shpalljes së Pavarsisë, protestoi me anën e një demonstrate. Në verën e vitit 1919, Fishta me cilësinë e sakretarit të përgjithshëm të delegacionit, shkon në Konferencën e Paqes në Paris e më tej në SHBA, ku duke udhëtuar me transoqeanikun "Cameronia" përjeton një aventurë të rrezikshme që e përshkruan vetë imtësisht, gjersa shprehet se "Nuk laçë as Shejt as Shejtneshë, pa merzitë at ditë". E megjithë atë, ai po në këtë vapor, shkruan kangën e gjashtë "Dervish Pasha", prej 483 vargjesh, mbi luftën turko - malazeze, me një vërtetësi të habitshme, sikur t`i kishte para syve ato vende dhe ato ngjarje, ku vajton edhe hallin e shqiptarëve. "Po aj vjen perse Stamolla / S`do qi t`hijë n`Shkoder Nikolla / Pse do vetë, po, edhe mbas sotit / Me t`majtë rob ajo si motit". Në vitet 1931, 32, 33 Gjergj Fishtën e gjejmë respektivisht në Athinë, Sofje e Bukuresht, ku merr pjesë në Konferencat Ballkanike që zhvilloheshin. Ai, largohet nga jeta politike për t`iu kushtuar fesë dhe sidomos krijimtarisë letrare, atje në Gjuhadoll, gjersa siç thamë, në vitin 1937 e boton të plotë "Lahutën e Malcisë" të cilën duar - duar kishte nisur ta botonte me kohë. Ndërroi jetë në fund të dhjetorit të vitit 1940, duke lënë pas një vepër të madhe që i dha emrin e një eruditi dhe atdhetari nga më të shquarit që vendi ynë ka nxjerrë gjatë gjithë historisë së tij. Te ne, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë e më tej ku ka shqiptarë, por edhe studiues të huaj, janë të shumtë ata që janë marrë me analizën e "Lahuta e Malcisë". Vlen të përmendim disa prej tyre, si fjala vjen Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, Stefan Çapaliku, Ndue Ukaj, Gjergj Zheji, Rudolf Marku, Zef Harapi, Martin Camaj, Anton Berisha, Kolë Kamsi, Lasgush Poradeci, Anton Harapi, Xhavit Beqiri, Tonin Çobani, Vehbi Bala, Robert Elsie, Shefkie Islamaj, Pjetër Jaku, Ali Aliu, Idriz Ajeti, Ernest Koliqi, Arshi Pipa, Bajram Kosumi, Milazim Krasniqi, Blerina Suta, Moikom Zeqo, Namik Resuli, Enver Mehmeti, Hektor Çiftja, e plot të tjerë, që i kam marrë nga autori serioz Xhavit Beqiri dhe që po i rreshtoj jo vetëm me mangësi, por edhe rrëmujshëm, gjë për të cilën kërkoj falje. Secili prej tyre jep mendimet dhe konsideratat e veta sipas asaj se ç`ka dashur të kumtojë nga kjo vepër, por në një gjë të gjithë bijen dakord; "Lahuta e Malcisë" është një epos heroik popullor. Edhe popujt e tjerë në trashëgiminë e tyre kulturore kanë pasur disa vepra të cilave u janë referuar herë pas here dhe kur kishin nevojë për një gjendje të shëndoshë shpirtërore, i nxirrnin ato në dritën e diellit. Kështu, mund të kujtojmë veprën e Homerit te grekët, "Eneida" e Virgjilit te latinët, "Ramajanan" e indianëve, "Eddan" e skandinavisë, "Nibelungo" e gjermanëve. Edhe në traditën tonë njihet si i tillë "Cikli i Mujit dhe Halilit", pra eposi i kreshnikëve. Dhe, pavarësisht se na parakalojnë heronj të bëmave, kohëve dhe vendeve të ndryshme, përsëri ata i bashkon e njëjta frymë: dëshira e pashuar për liri, trimëria deri në vetflijim për mbrojtjen e nderit dhe atdheut dhe mençuria gjatë dialogut me miq e armiq. Në këtë kuptim, të gjithë ata, që nga Gjergj Kastrioti e deri te Ded Gjo Luli, ruajnë po atë burrëri e guxim ndaj pushtuesve: "N`at Malci, n`at Rapshë t`Hotit / Dedë Gjo Luli, burrë si motit, / ...Shtremnon ksulen, del në shkallë, / Bedri Pashës po i çon aj fjalë: / ... Se ma sodjet, emni i Zotit! / Shka jem nipash s`Gjergj Kastriotit / E "Shqyptarë" qi i thomë na vedit, / Ma duva nuk i bajm Mbretit." Por, "Lahuta" nuk është vetëm memorie historike. Studimi i saj është bërë dhe do të vazhdojë të bëhet edhe letrarisht edhe gjuhësisht, pasi ai mbetet një thesar i vyer i kulturës tonë, të cilin koha kur u ndalua, jo vetëm që nuk arriti ta çrrënjosë nga kujtesa popullore, por dhe ja shtoi edhe më shumë rëndësinë. Se është ashtu sikurse pohon Sh. Islamaj: "Fishta e gjeti rrugën e rrahur, por nuk u mjaftua me kaq: ai ndihmoi që gjuha pop-

(Vijon në faqen 11)

LETRAT

RECENSION

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT *(varianti i Pukës)* NË NJË BOTIM TË RI

Indriz Ahmetaj

Këto ditë doli nga shtypi në qarkullim botimi i dytë i Kanunit të Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës) i autorit Xhemal Meçi (Mjeshtër i Madh).

Edhe ky si dhe librat e tjerë të autorit është i nivelit dhe formatit akademik.

Kanë kaluar pak më shumë se njëzet vjet nga botimi i parë i këtij Kanuni (1996) dhe u ndje nevoja për ta patur në duar akoma më shumë njerëz këtë vepër të denjë të etnografisë shqiptare, pjesë e së cilës është edhe e drejta zakonore. Ky botim i ri është shumë i përmirësuar në përmbajtje si libër, por jo vetë Kanuni dhe në formën e paraqitjes. Ashtu siç thotë autori: "Ky botim i dytë u bë i nevojshëm si rezultat i kërkesave të lexuesve dhe studiuesve, pasi botimi i parë ka qarkulluar i tëri si këtu në Shqipëri, në Kosovë dhe pjesërisht në Maqedoninë e Veriut, Ulqin (Mali i Zi), për më tepër deri në Europën Perëndimore dhe SHBA, duke mos mbetur asnjë kopje". Botimit të dytë i janë shtuar edhe kumtesat e mbajtura në veprimtaritë për të drejtën zakonore, siç janë promovimi i botimit i vitit 1996 dhe Simpoziumi i Parë "Për traditën juridike shqiptare" (26 shtator 1997), me kumtesat e Prof. Dr.Mark Tirta (Akademik), Sadri Fetiu, Prof. Dr. David Luka, Prof. Dr.Musa Kraja, Prof.Dr. Agron Xhagolli Drita Halimi, Prof. Dr. Ismet Elezi.

Janë përfshirë edhe shkrime të botuara nga autori në shtypin periodik e shkencor, si: "Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe Aleksandri i Madh" dhe "Kanuni i Lekë Dukagjinit (varianti i Pukës)- arritje e shënuar në etnologjinë shqiptare" e studiuesit Gjovalin Alia, si dhe disa vlerësime për autorin. Në këtë botim të dytë libri ka evidentuar ndryshime e përmirësime edhe në formë. Nëse në botimin e kaluar ishin përdorur shkronja shumë të holla e letër kontrastuese, në këtë botim shkronjat janë më të mbushura dhe sfondi i përshtatshëm për syrin. Edhe kopertina është me letër cilësore.

Përralla e të gjithëpushtetshmit

" Tirania më e egër është ajo që vepron nën hijen e ligjshmërisë dhe del me flamurin e drejtësisë" - Montoskjé

Nga Liljana Muça

Dikur e dikur... në kohë të largëta na ishte njëherë një perandor. Përsëri dikur... na ishte njëherë një i gjithëpushtetshëm, i cili me çmenduritë e tij mendonte se zotëronte universin dhe dirigjonte kohën.

Por një ditë, në një kohë, në një pikë të kësaj Toke, kur dielli si gjithmonë ndriçonte për të gjithë njëlloj, kur koha pa çarë kokën për kërkënd ecte me metrin e saj. Ai, i gjithëpushtetshmi, si papritur, por edhe pritur, u gjend fare i pafuqishëm, siç i munduri glaudiator nga më i fuqishmi glaudiator.

Nuk deshi ta besonte dhe madje as ta pranonte. Por... oh, sa i pafuqishëm po ndjehej! Nuk ishte më Supremi. Paskësh një Suprem tjetër më të madh, të cilin nga tribunat e << fitorjeve >> e kishte mohuar, e kishte sharë, por tani... oh, ai të bëka të të vijë mëndja vërdallë!

Në çast, të gjitha orenditë e dhomës, i pa kokëposhtë. Në atë vorbull marramendëjeje dhe lëmshi filozofish, me mundim të madh mundi që të frenonte mendimin në thënien e mosdëshirueshme se; "Bota qenka me rrota". Cili filozof ta kishte thënë; Sokrati, Niçja, Makiaveli apo kush tjetër?!

Nuk po i kujtohej se kush ta kishte thënë-botën me rrota- ndoshta asnjëri nga këta, por ama filozofia e Makiavelit se; "Mjeti përligj qëllimin" iu kujtua fare qartë, ngaqë e kishte patur fort për zemër thënien e tij. Ja atje në fund të dhomës, në tavolinën këndore, ishte një mjet. Ishte një poçe e madhe kineze, dhuruar për ditëlindje me mbishkrimin e një miku idealesh. Po ashtu, ishte një mjet edhe bastuni i fortë larë me flori, i cili kishte ardhur nga Franca prej një miku tjetër idealesh. Eh, Franca...! Nëse ndokush me qëllimin dashakeqas do të ishte gjendur si "papritur" në dhomën e tij. Ai ato "dhurata të paqme" do t'i kishte kthyer në mjete ndëshkuese, mjafton që me ato të godiste kokën e një kokëboshi që kishte guxuar të ngjitej në Olimp. Hodhi sytë nga poçja. Ishte aty por me kokë poshtë.

Në tavolinën e tij të punës, gjysëm shekulli më parë e në vazhdim, mbi të bardhën ishte vulosur e zeza, ishte prangosur liria, ishte vrarë jeta dhe të gjitha këto, në emër të lirisë. Sepse të gjithë tiranët e kësaj toke kanë besuar tek liria e vetvetes, duke e siguruar atë tek shtypja e popullit të tyre. Ai i gjithpëpushtetshmi, diskriminimin, intrigat, klanet dhe kurthet e gatuara ne kuzhinën e shtrigave i kishte patur mjet pune që do të thoshte; baltë mbi të vërtetën, të cilat kjellët përmbushin Qëllimin e Zi, të nënshkruar me Stilografin-Mjet prej qelibari.

"Urdhëroj, të pushkatohet"!

"Urdhëroj, të internohet"!

"Urdhëroj, të zhduket pa lënë gjurmë"!

Eh, bota me rrota! Gjuha filloi të trashet dhe ndjeu se s'do mund të fliste dot më. Gjoja po i thahej dhe fryma po i zihej. Provoi një siklet të jashtëzakonshëm. Sytë iu zgurdulluan, jashtë mase frikshëm.

Personeli, edhe pse ashtu i shtrirë, kur rrugën e kishte marrë për tjetë botë, ia pati përsëri frikën.

Ai bëri t'iu bërtasë e t'i godasë, por nuk mundi... Dhoma filloi të rrotullohej e të rrotullohej dhe çdo gjë brënda atyre kontureve humbi formën për të marrë një tjetër formë, atë të një honi të zi e gjigand. E pa veten se po përpihej nga shtjella e atij honi me gojë stërmadhe. Dikur e kishte injoruar Danten duke thënë; "Broçkulla"! Mendimi i fundit ishte: "Po më pritka ferri". Si, shumkërkush që ikën nga kjo botë me një peng në zemër, edhe të gjithëpushtetshmit i mbeti një peng. Kishte dashur të hartonte një dekret të posaçëm ku në atë fletë ogurzezë të shkruhej: "Njerëzve u lejohet të marrin frymë vetëm me lejen time" Por... zuri shtratin, si tani. Hija e vdekjes nuk e kurseu me krahët e saj të gjatë. Personeli mori frymë lirshëm, teksa e panë ashtu të shtrirë pa jetë. Nga dritaret e hapura hyri një fllad i ngrohtë pranveror me aromën e luleve të prillit. Ishte Prill... Ajri nuk ishte i ndaluar dot, as edhe Liria.

EMRI I GJERGJ FISHTËS DHE JEHONA E LAHUTËS SË TIJ DO TINGËLLOJNË PËR JETË MADHËRISHËM MES SHQIPTARËVE

(Vijon nga faqja 10)

ullore, jo vetëm të ecë qëndrueshëm nëpër kohën e saj, po të bëhet gjuhë, vërtetë artistike, me tiparet e një gjuhe të zhvilluar e të gatshme për t`u bërë gjuhë për vepra të mëdha, që do të krijohen pas tij e në historinë e saj të pashkëputur". Dhe ndofta, gjuhëtari austriak, pjesëmarrës në punimet e Komisisë Letrare Shqipe, ai që veç të tjerash ka shkruar në vitin 1958 "Epika popullore shqiptare" , pra Maksimilian Lamberci, e ka përcaktuar rëndësinë e vërtetë të kësaj kryevepre, duke thënë se "... sa më shumë vjet që të kalojnë aq ma vlerë merr, tue qenë se ajo është pasqyra, magazine e kopja besnike e jetës, e shpirtit, e dëshirave, e përpjekjeve, e luftës dhe vdekjes së shqiptarëve." Pra, "Lahuta e Malcisë", me nxitjen e dashurisë për Atdhe dhe krenarisë për të shkuarën tonë, merr rëndësinë që ka Himni ynë Kombëtar, ndaj do njohur nga brezat e sotëm dhe ata që do të vinë. Po ashtu, nuk duhen harruar kurrë fjalët e fundit të Homerit tonë, që së shpejti i bëhen plot 79 vjet që u nda nga jeta se: "Po des kondend, përse kam punue për Fe, për Atdhe e për Provinçë; e po ju a le porosi, qi edhe ju të punoni për Fe, për Atdhe e për Provinçën tonë".

SPECIALE

GJENERAL PARLLAKU, legjendari i pavdekshëm!

Nga Kadri MORINA

Në kohën tonë moderne të globalizmit, nuk bëhet fjalë për legjenda. Megjithatë, ato ekzistojnë, pavarësisht heshtjes dhe indiferencës së opinionit publik. Një protagonist me një jetë të jashtëzakonshme ishte (dhe mbetet) pa dyshim gjeneral-lejtënant Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, i ndarë nga jeta para pesë muajsh. Është fat për një komb si i yni që kishte (dhe ka) një enciklopedi si gjenerali legjendë në kufirin e dy kohëve. Nga vështrimi i jetës së tij, na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi i tij atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur. Nga ëndrra e tij dhe e brezit të tij për një shoqëri të njerëzve të barabartë, që e kërkoi atë nëpërmjet komunizmit si ideologji, vjen edhe zhgënjimi i madh prej kësaj utopie, që u përpoq të imponohej nëpërmjet luftës së klasave. Nga një çerekshekulli i dënimit të tij, nga plumbi dhe vdekjet në qelitë e burgut, mund të njohim një nga pamjet më makabre të dhunës së diktaturës. Ndaj nuk është rastësi që në vlerësimin e shkrimtarit dhe politologut të mirënjohur Teodor Laço: "Gjeneral Rrahman Parllaku nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të ishte një grishje për fantazinë. Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e këtij heroi legjendar".

Nga veprimtaria e gjeneral Parllakut si veteran në këtë çerekshekulli të demokracisë, bashkë me të tjerë ish-të

dënuar si L.Belishova, E.Ohri, H.Ramohito etj, apo edhe e kryetarit të ri të OBVL-së, Kol.Ing.Myfit Guxholli, mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Identiteti i gjeneral Parllakut mbetet i derdhur që nga fëmijëria, aty ku për vite të tëra ndarjeje bashkohej Verilindja shqiptare me Kosovën shqiptare, lirija e së cilës ishte "Ëndrra e jetës së tij". Dashuria për vendlindjen është një nga ndjenjat më të bukura. Kush e shpërfill, dëshmon për një shpirt të varfër. Jeta, lidhja me vendlindjen është zanafilla e respektit të tij për njeriun e thjeshtë, e humanizmit dhe altruizmit. Këtë amenat na e la ai që jeta dhe vepra e tij e veshi me pavdekësi, legjendari Rrahman Parllaku.

Përjetë mirënjohës Gjeneral Parllakut

Genci BALLANCA
Kryetar i Degës së OBVL Durrës

Veteranët e LANÇ, pasardhësit, familjet e tyre dhe i gjithë populli shqiptar përulen me nderim e respekt të veçantë para veprës të Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit, Rrahman Parllaku. Veçanërisht ne bashkëpunëtorët e tij, themelues, drejtues dhe anëtarë të Degës së OBVL-së Durrës do t'i jemi përjetë mirënjohës Atij burri të rrallë, që me veprimtarinë e tij si luftëtar e drejtues i njësive të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe i Ministrisë së Mbrojtjes bëri epokë.Kurrë nuk do të harrojmë kontributin e tij në vlerësimin e personaliteve të shquara, si në rastin e shpalljes së Nako Spiros "Qytetar Nderi i Durrësit", vendosjen e emrit të tij një rruge të qytetit bregdetar, si dhe i disa personaliteve tjera të organizatës tonë.

Gjeneral Parllaku do të kujtohet gjithnjë me nderimet që meritonte, jo vetëm nga familjarët, por dhe nga miqtë dhe të afërmit, bashkëluftëtarët dhe bashkëpunëtorët, shqiptarët e ndershëm e patriotë kudo që janë, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në hapësirën mbarëshqiptare në botë.

EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH